



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Psikologji
Ligjore”**

ofruar nga

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:


Prof.Asoc.Dr. Erika MELONASHI

Prof.Asoc.Dr. Naim MËÇALLA

Maj/ 2025

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT
Master Profesional në “Psikologji Ligjore”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Psikologji Ligjore”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër i MASR Nr. 660, datë 11.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr. 215, datë 19.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	N/A
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	N/A
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	9 PAE/3 PAK për vitin akademik 2023-2024 9 PAE/ 2PAK për vitin akademik 2022-2023
18	Numri i studentëve:	2022-2023 19 studentë
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti i Tiranës është licensuar si institucion i arsimit të lartë me VKM Nr. 207, datë 30.05.1957 dhe akredituar si Institucion i Arsimit të Lartë, me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 62, datë 21.09.2017. Fakulteti i Shkencave Sociale, pranë Universitetit të Tiranës përbëhet nga pesë departamente përfshi: Departamenti i Filozofisë, Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë, Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, Departamenti i Sociologjisë dhe Departamenti i Shkencave Politike.

Programi i studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore” ofrohet nga Departamenti i “Pedagogjisë dhe Psikologjisë” pranë këtij fakulteti. Programi është hapur me Urdhër të MASR Nr 660, datë 11.10.2018, si një program studimi 1 vjeçar (2 semestra) me 60 ECTS. Programi ofrohet me kohë të plotë në gjuhën shqipe dhe në përfundim të ciklit lëshohet diploma Master Profesional në “Psikologji Ligjore” (Urdhër Nr. 215, datë 19.06.2023).

Programi përfshin lëndë të formimit të përgjithshëm, lëndë karakterizuese të programit, lëndë ndërdisiplinore/integruese, si dhe lëndët plotësuese, në përputhje me VKM 41 si dhe Vendimin Nr. 185, Datë 25.3.2021 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018. Detyrimet përmbyllëse të programit përmbushen përmes realizimit të temës së diplomës, e cila mbart peshën 15% të krediteve të programit. Për vitin akademik 2023-2024 janë regjistruar gjithsej 19 studentë në këtë program studimi.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm synon të paraqesë shkallën e përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë, të Programit Master Profesional në Psikologji Ligjore, në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”.

Grupi i vlerësimit të jashtëm nisi punën për realizimin e procesit të vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programit të studimit, me shqyrtimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga IAL dhe më pas vizitën në Institucion. Ky raport përfundimtar është hartuar duke marrë parasysh të dy komponentët e sipërpërmendur, gjithmonë në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit.

Ekspertët e bazuan vlerësimin e tyre në 6 fushat kryesore përfshi: Ofrimi i Programit të Studimit, Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të ciklit të dytë; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat; Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit; Studentët dhe Mbështetja e tyre, Sigurimi i Cilësisë së Programit të studimit. Raporti identifikon pikat e forta dhe të dobëta të programit si dhe mundësitë për zhvillim dhe përmirësim të mëtejshëm. Mbi bazën kësaj analize grupi i vlerësimit të jashtëm ka dhënë edhe rekomandimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë së Programit Master Profesional në Psikologji Ligjore.



4



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Psikologji Ligjore”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Në përputhje me Statutin e Universitetit të Tiranës dhe Rregulloret përkatëse në nivel Fakulteti dhe Departamenti, Universiteti I Tiranës ofron programe studimi të cilat synojnë konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. Programi i studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore”, i ofruar nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë, në Universitetin e Tiranës, ofrohet në përputhje me interesat kombëtare duke konsoliduar më tej vlerat akademike e kulturore përmes formimit të profesionistëve të ardhshëm në përputhje me nevojat e komunitetit për këtë shërbim. Studentët e këtij programi si profesionistë të ardhshëm do të japin një kontribut në rritjen e cilësisë së shërbimit në institucione të ndryshme si gjykata, burgje etj. duke adresuar nevojat kombëtare në këtë drejtim. <i>Ev. Statuti i Universitetit të Tiranës (akses. online 09.03.2025)</i> <i>Ev. 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.</i> <i>Ev. 3.3. Rregullore e departamentit.</i> <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore është në përputhje me misionin dhe vizionin e Universitetit të Tiranës, sikundër parashtrohet në Statutin e Institucionit dhe Rregulloret përkatëse në nivel Fakulteti dhe Departamenti, për të formësuar profesionistë të denjë në shërbim të komunitetit. Fusha e veprimtarisë së institucionit ka përfshirë prej fillimeve të veta Shkencat Sociale në përgjithësi dhe Psikologjinë në vecanti si një drejtim kryesor akademik. Vlerësohet se programi përkatës Master i Shkencave në “Psikologji Ligjore” ofrohet plotësisht në përputhje me fushën e veprimtarisë së IAL.

	<u>Ev. Statuti i Universitetit të Tiranës (akses. online 09.03.2025)</u> <u>Ev. 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.</u> <u>Ev. 3.3. Rregullore e departamentit.</u> <u>Ev. 3.6. Rregullore e programit te studimit</u>			
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	Programi Master Profesional në “Psikologji Ligjore” ofrohet në zbatim të Strategjisë për Zhvillim të Fakultetit për të formuar profesionistë në fushën e shkencave sociale, të pajisur me njohuri shkencore dhe në shërbim të komunitetit. Si Statuti i Universitetit dhe Rregulloret përkatëse të Fakultetit dhe Departamentit përfshijnë Psikologjinë si një nga drejtimet kryesore akademike. <u>Ev. Statuti i Universitetit të Tiranës (akses. online 09.03.2025)</u> <u>Ev. 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.</u> <u>Ev. 2.3. Strategjia e Zhvillimit e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023-2028.</u> <u>Ev. 3.3. Rregullore e departamentit.</u> <u>Ev. 3.6. Rregullore e programit te studimit</u>			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi Master Profesional në Psikologji Ligjore është në përputhje me strategjitë kombëtare për zhvillim duke formësuar profesionistë të aftë në shërbim të komunitetit. Programi gjithashtu reflekton qartësisht prirjet globale të zhvillimit, përmes formësimit të psikologëve të cilët punojnë në sistemin e drejtësisë, gjykata, burgje etj. <u>Ev. 3.6. Rregullore e programit te studimit</u> <u>Ev. 4.1. Korniza konceptuale e programit te studimit</u>			
Konkluzione	Programi Master Profesional në Psikologji Ligjore i ofruar nga Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë pranë Universitetit të Tiranës është në përputhje me interesat dhe vlerat kombëtare, fushën e veprimtarisë së institucionit si dhe prirjet globale, duke kontribuar në formësimin e profesionistëve të aftë për të punuar në sistemin e drejtësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti i Tiranës ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura për të ofruar programin Master Profesional në Psikologji Ligjore. Infrastruktura e universitetit dhe burimet njerëzore konsiderohen gjithashtu të përshtatshme për ofrimin e këtij programi studimi. Ky fakt dëshmohet përmes cilësisë së kurrikulës, stafit akademik të përfshirë në programin e studimit si dhe infrastrukturës përkatëse. <i>Ev. 4.15. CV e personelit akademik dhe ndihmes akademik për programin e studimit.</i> <i>Ev. 4.2. Plani mesimor i programit të studimit.</i> <i>Ev. 4.13. Te dhenat për infrastrukturen në funksion të programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Njësia kryesore përgjegjëse për Programin e Studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore, është Fakulteti i Shkencave Sociale, pjesë e të cilit është njësia bazë që ofron programin e studimit (Departamenti I Pedagogjisë dhe Psikologjisë). Sipas ISCED-F (International Standard Classification of Education) (2013) fusha e programit klasifikohet nën kategorinë 03 – Social sciences, journalism and information. Programi është organizuar në 2 semestra 60 ECTS, ofrohet në gjuhën shqipe dhe përfundon me dhënien e diplomës Master Profesional në “Psikologji Ligjore”. <i>Ev. 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023.</i> <i>Ev. International Standard Classification of Education (ISCED-F, 2013)</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e	Programi Master Profesional në “Psikologji Ligjore” ofrohet nga Departamenti I Pedagogjisë dhe Psikologjisë, cka dëshmon përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të kësaj njësie si dhe direktivat dhe udhëzimet kombëtare dhe evropiane në lidhje me programet e studimit.

programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Ev. 3.3. Rregullore e departamentit. Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit			
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	N/A			
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Studentët e diplomuar janë pjesë e netëork-ut profesional të Institucionit. Gjatë vizitës në IAL, GVJ konstatoi se në takimet me studentët u përmend përfshirja e Alumnit të këtij programi si pika kyce për trajnimin e studentëve ekzistues. Vlerësohet pozitivisht fakti që institucioni mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe i përfshin ata në aktivitete akademike. Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës			
Konkluzione	Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. GVJ konstaton si pikë të fortë rrjetin e studentëve të diplomuar (alumni) të cilët vazhdojnë të jenë pjesë e jetës akademike në Institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisht profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së	Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë bashkëpunon ngushtësisht me njësitë e tjera brenda institucionit përfshin Zyrën e Kurrikulave, Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Burimeve Njerëzore, Zyrën e kujdesit ndaj studentit etj. Ky bashkëpunim produktiv u konstatua edhe gjatë vizitës në insitucion dhe takimeve specifike me strukturat përkatëse.

detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës Ev. 3.3. <u>Rregullore e departamentit.</u>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Sipas evidencës dokumentare të dorëzuar konstatohet se Institucioni ka në zbatim mbi 100 marrëveshje bashkëpunimi me institucione në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar nga të cilat 36 janë në funksion të programeve që mbulon Fakulteti I Shkencave Sociale. Këto marrëveshje janë në funksion të përmirësimit të cilësisë së programit të studimit, përmes lehtësimit të procesit të praktikave profesionale, apo aksesit në mbledhjen e të dhënave për temat e diplomave, sikundër u pohua nga studentët gjatë vizitës në institucion. Ev. 3.17. <u>Lista e marreveshjeve te bashkepunimit dhe e partnereve per praktiken profesionale.</u> Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademikt dhe studentëve.	Përveç marrëveshjeve në nivel institucional, Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë ka nënshkruar marrëveshje specifike të cilat lidhen drejtpërsëdrejti me Programin e Studimit Master Profesional në "Psikologji Ligjore". Shembuj përfshijnë: Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, Instituti Shëndetësor i Veçantë për të Burgosurit, IEVP Ali Demi, IEVP Mine Peza, IEVP Jordan Misja, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, Qendra për Shërbime Psiko-Ligjore "Family", Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës etj. Gjatë takimit me studentët ata pohuan se elementët e praktikës të siguruar përmes këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit, i aftësojnë ata për profesionin e tyre të ardhshëm. Ev. 3.17. <u>Lista e marreveshjeve te bashkepunimit dhe e partnereve per praktiken profesionale.</u> Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet	Njësia përgjegjëse për programin, Fakulteti i Shkencave Sociale përshin analizën e marrëveshjeve të bashkëpunimit në raportimin vjetor- Analiza vjetore e punës së Fakultetit. Kjo analizë shërben si një reflektim për arritjet dhe vendos synime për zhvillimet e ardhshme, gjithmonë në funksion të përmirësimit të cilësisë së

e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	programit të studimit. <u>Ev. 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023.</u> <u>Ev. 3.19. Raport i fundit periodik analitik i perfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit</u>			
Konkluzione	Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me palë të treta në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Gjithashtu IAL paraqet evidenca në formën e raporteve analitike për zbatimin e këtyre marrëveshjeve në funksion të realizimit të programit të studimit, psh., aftësimi profesional, kërkimi shkencor, mobiliteti etj..			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe	Programi i studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore” është organizuar në përputhje me legjislacionin vendas dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai ofrohet si program studimi me kohë të plotë, 1 vit akademik, 60 ECTS. Veprimtaritë formuese të programit A-E janë në përputhje me Ligjin e Arsimit të lartë si dhe VKM 41. Sipas peshës së krediteve për kategori, specifikisht: A Lëndë bazë 5% ECTS B Lëndë karakterizuese 40% ECTS C Lëndë ndërdisiplinore 30% ECTS

Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	D Lëndë plotësuese 10% ECTS E Detyrime përmbyllëse 15% ECTS <i>Ev. 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit në Psikologji Ligjore.</i> <i>Ev. 4.2. Plani mësimor, i Programit Master Profesional "Psikologji Ligjore"</i> <i>Ev. 4.3.1. Programet e mësimore të lëndëve për programin e studimit 2023-2024.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Programit i studimit Master Profesional në "Psikologji Ligjore" pajis studentët me njohuri të thelluara në fushën e psikologjisë ligjore duke zhvilluar kompetencat e tyre në vlerësim dhe ndërhyrje në kontekstin ligjor. Në këtë mënyrë studentët mund të punojnë me klientët në kontekste të ndryshme si gjykatë, prokurori, burg, paraburgim, shërbim prove, rajon policie etj Në këtë mënyrë studentët fitojnë njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për orientim në tregun e punës, dhe zgjidhjen e problemeve komplekse me të cilat mund të përballen më tej në jetën e tyre profesionale. <i>Ev. 3.6. Rregulloret e programit të studimit</i> <i>Ev. 4.2. Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Sipas kurrikulës së Programit Master Profesional në Psikologji Ligjore, Praktika Profesionale mbart peshën 10% të krediteve ose 6 ECTS ndërsa Punimi i Diplomës mbart peshën 15% të krediteve ose 9 ECTS. Kjo ngarkesë në kredite është në përputhje me Vendimin Nr. 185, Datë 25.3.2021 Për Disa Ndryshime Dhe Shtesa Në Vendimin Nr. 41, Datë 24.1.2018. <i>Ev. 4.2. Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të	N/A

parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	N/A
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	N/A
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet	Sikundër u konfirmua edhe gjatë vizitave në institucion por aktualisht Universiteti i Tiranës është i vetmi që ofron një Program Master në Psikologji Ligjore. Evidenca: Shënime gjatë vizitës.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së	Programi I studimit ka numër unik identifikimi UT3117231885, të lëshuar nga Qendra e Shërbimeve Arsimore pranë Ministrisë së Arsimit.

studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	<i>Ev.3.7. Shkresa QSHA për kodin e programit të studimit.</i> <i>Ev. 3.8. Shkresa QSHA për rregjistrimin e formës së diplomës</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	N/A			
Konkluzione	<i>Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore, në lidhje me strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, dhe numrin e krediteve. Programi nuk zhvillohet në bashkëpunim me asnjë institucion tjetër të arsimit të lartë vendas ose të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit është Fakulteti i Shkencave Sociale, I cili përbëhet nga 5 departamente: 1. Departamenti i Filozofisë, 2. Departamenti i Pedagogjisë dhe i Psikologjisë, 3. Departamenti i Punës dhe Politikës Sociale, 4. Departamenti i Sociologjisë, 5. Departamenti I Shkencave Politike. Njësia bazë që ofron programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore” është Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë. Njësia bazë përmbush detyrimet e përcaktuara në lidhje me stafin akademik, dhe numrin e anëtarëve të personelit akademik efektiv. Përkatesisht në vitin 2022-2023, përbërja e

stafit ishte 9 PAE dhe 3 PAK ndërsa për vitin akademik 2023-2024 9 PAE dhe 2 PAK.

Të dhënat për Departamentin e Pedagogjisë-Psikologjisë:

Tituj/ grada	2022 – 2023		2023 – 2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	1	-
Prof. Asoc.	3	-	4	-
Dr./PhD.	3	1	3	-
Msc.	2	2	1	2
Totali	9	3	9	2

Nga sa më sipër Departamenti i Pedagogjisë-Psikologjisë plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 23 të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë.

Ev. 4.17 Aneks tabelat përmbledhëse ASCAL

Ev. 2.4. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Sociale 2023

Ev. 4.6. Të dhënat tabelore për personelin akademik për programin e studimit

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përcakton udhëheqësin e praktikave mësimore, i cili është anëtar i stafit akademik. Në bashkëpunim me personelin ndihmës akademik dhe administrativ si psh Zyra e Kujdesit ndaj Studentit, Alumni etj, departamenti sigurohet për mbarëvajtjen e praktikave mësimore në përputhje me kërkesat dhe zhvillimet e tregut. Gjatë vizitës në institucion, GVJ takoi nga afër edhe alumni të këtij programi të cilët bashkëpunojnë në kuadër të realizimit të praktikave mësimore ose orëve të seminarit/leksione të hapura në kuadër të lëndëve të ndryshme.

Ev. 4.4. Paketa e praktikës për programin e studimit


Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia bazë që ofron programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Psikologji Ligjore” ka përcaktuar njërin prej anëtarëve të stafit akademik si Koordinator të këtij programi studimi, në zbatim të VKM 531, datë 11.09.2018 “Për miratimin e Kodit të Cilësisë të Arsimit të Lartë”. Koordinator i programit angazhohet në mbarrëvajtjen e veprimtarisë mësimore, praktikave profesionale etj. si dhe raporton në mënyrë periodike tek drejtuesi i njësies bazë për çdo problematikë të evidentuar. <i>Ev3.11 Vendim për emërimin e koordinatorit të programit të studimit.</i> <i>Ev 3.12 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit të studimit.</i>			
Konkluzione	Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë, përfshi strukturën akademike, zhvillimin e praktikave profesionale dhe koordinatorin e programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Departamenti I Psikologjisë dhe Pedagogjisë, përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore” disponon gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Këtu përfshihen: Rregullorja e programit të studimit, Plani mësimor i programit, Syllabuset e lëndëve, dhe Korniza konceptuale e programit. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev.4.1, Korniza konceptuale e programit të studimit në Psikologji Ligjore.</i> <i>Ev. 4.2. Plani mësimor, i Programit Master Profesional “Psikologji Ligjore”.</i> <i>Ev. 4.3.1. Programet mësimore të lëndëve MP Ligjore 2022-2023.</i>

	<i>Ev. 4.3.1. Programet mësimore të lëndëve MP Ligjore 2023-2024.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit përmban planin mësimor, të organizuar në 2 semestra, 30 ECTS secili. Ngarkesa është e balancuar mes semestrave dhe e detajuar në orë mësimore brënda dhe jashtë auditorit. Programi është në përputhje me udhëzimet për shpërndarjen e veprimtarive formuese në kategoritë e lëndëve bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore” integruese, (praktika) dhe detyrime përmbyllëse. <i>Ev. 4.2. Plani mësimor, i Programit Master Profesional “Psikologji Ligjore”.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve paraqiten në Rregulloren e Programit të studimit” si dhe në “Rregulloren e Sekretarisë Mësimore” dhe “Rregulloren e transferimeve të studentëve”. Miratimi i kuotave për programin e studimit ndjek procedurën standarde të përcaktimit të kriterëve nga njësia bazë dhe miratimit me vendim senati. Bazuar në vendimin e senatit për miratimin e kuotave të pranimit për vitin akademik 2023-2024, nga 30 kuota të propozuara, 25 janë për shtetas shqiptar brenda vendit, 2 kuota për aplikantë për program të dytë studimi, 1 kuotë për transferimet e studentëve, 2 kuota për minoritetin. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev. 3.13Vendimi Senati Akademik. Mbi miratimin e kuotave të pranimit në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe të tretë. 2023-2024.</i> <i>2.9. Rregullore e Sekretarisë Mësimore 2018.</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore mban gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me syllabuset e lëndëve, praktikën mësimore, si dhe orët brënda dhe jashtë auditorit. Rregullorja e programit të studimit gjithashtu specifikon frekuentimin e procesit mësimor si dhe mënyrat e kontrollit dhe vlersimit të dijeve. Syllabuset e detajuara të çdo lënde janë hartuar në përputhje me shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 bazuar në planin mësimor të programit. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit.</i>

	<i>Ev. 4.2. Plani mësimor, i Programit Master Profesional "Psikologji Ligjore".</i> <i>Ev. 4.3.1 Programet mësimore të lëndëve MP Ligjore 2022-2023.</i> <i>Ev. 4.3 Programet mësimore të lëndëve MP Ligjore 2023-2024.</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Përmbajtja e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Psikologji Ligjore" është në përmirësim të vazhdueshëm pasi monitorohet nga njësia bazë çdo vit akademik, me qëllim përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Syllabuset rishikohen cdo fillim viti duke reflektuar ndryshimet e nevojshme në përputhje me zhvillimet më të fundit. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev. 4.3.1. Programet mësimore të lëndëve MP Ligjore 2022-2023.</i> <i>Ev. 4.3. Programet mësimore të lëndëve MP Ligjore 2023-2024</i>			
Konkluzione	<i>Njësia bazë disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. GVJ konstatoi se programi ka Rregulloren përkatëse të organizimit dhe funksionimit, Programet lëndore të cilat rishikohen cdo vit si dhe Planet mësimore të detajuara me orët brënda dhe jashtë auditorit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore mundëson thellimin e njohurive të marra në nivelin Bachelor, duke kanalizuar studentët drejt aspektit praktik të punës së psikologut në sistemin e drejtësisë. Sikundër përmendet nga vetë studentët por edhe pedagogët gjatë vizitës në institucion, përmes veprimtarive formuese dhe sidomos aspektit praktik të lëndëve (krahas praktikave profesionale), programi krijon mundësi për të ndërtuar një profil të specializuar të studentit, duke e përgatitur atë më së miri për tregun e punës. <i>Ev. Minutat: Shënime nga vizita në institucion</i>

Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	<i>Ev. 4.3. Programet mësimore të lëndëve MP Ligjore 2023-2024</i> Shpërndarja e lëndëve dhe moduleve nëpër semestra mundëson arritjen e objektivave formues të programit duke e drejtuar studentin gradualisht nga lëndë të përgjithshme të semestrit të parë drejt atyre me karakter të mirëfilltë profesional, të cilat mundësojnë thellim të njohurive dhe kompetencave në profilin ligjor. Shpërndarja në semestra është e balancuar, me 30 ECTS në semestër, duke respektuar numrin e krediteve në lëndët bazë, karakterizuese, ndërdisiplinarefintegruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. <i>Ev. 4.2. Plani mësimor i programit të studimit</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Struktura e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore reflekton karakterin ‘profesional’ të këtij programi, duke aftësuar studentin për tregun e punës. Gjatë vizitës në institucion, si nga pedagogët edhe nga studentët u theksua aspekti praktik I secilës lëndë, duke përmendur shembuj si përdorimi I case study, role play, instrumentave vlerësues, detyrave praktike etj. Në këtë mënyrë lëndët e programit sigurojnë një formim të thelluar profesional të studentit, I cili pasurohet më tej përmes realizimit të praktikave profesionale në një gamë të gjerë institucionesh të lidhura drejtpërsëdrejti me profilin e psikologut ligjor. <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i> <i>Ev. 4.2. Plani mesimor i programit të studimit</i> <i>Ev. 4.3. Programet mesimore të lendeve 2023-2024</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi Master Profesional në Psikologji Ligjore është ndërtuar sipas modeleve më të mira ndërkombëtare dhe është i ngjashëm me programe të tjera ndërkombëtare ofruar në këtë fushë, fakt ky që lehtëson mobilitetin e studentëve (programe Erasmus) apo transferimin e studimeve jashtë vendit. Gjithashtu studentët e këtij programi, në përfundim të studimeve, janë aftësuar për të ndjekur të gjitha procedurat e parashikuara në legjislacion për licensimin në profesionin e psikologut ligjor. Për këtë arsye konkludohet se veprimtaritë formuese të këtij programi mundësojnë arritjen e objektivave formues në mënyrën më të mirë duke facilituar mobilitetin apo punësimin e ardhshëm të studentëve. <i>Ev. 4.1. Korniza konceptuale e programit të studimit</i>

	<i>Ev. 4.3. Programet mesimore te lendeve 2023-2024.</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Program Master Profesional në “Psikologji Ligjore” monitorohet nga njësia bazë dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Syllabuset janë hartuar nga titullare që i përkasin kategorisë “Profesor” dhe literatura e përdorur përgjithësisht është në linjë me tipologjinë e lëndës dhe me tekste që i përkasin viteve të fundit. Janë evidentuar vetëm disa shmangie të vogla, në të cilat raste pedagogët sqaruan se u vijnë në ndihmë studentëve me cikle leksionesh të përgatitura dhe rifreskuara cdo vit akademik.
	<i>Ev. 4.3. Programet mesimore te lendeve 2023-2024.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e Programit Master Profesional në Psikologji Ligjore pajis studentët me njohuri të thelluara në fushën e psikologjisë ligjore, si dhe aftësi e kompetenca për vlerësimin e rasteve dhe ndërhyrjen psikologjike në kontekste të ndryshme si gjykata, burgje, shërbim prove etj. Nga takimi me pedagogët e angazhuar në programin e studimit, u konkludua se kurrikula është ndërtuar në linjë me programet më të mira ndërkombëtare dhe zbatimi i saj realizohet duke u fokusuar në aftësimin profesional të studentëve, në përputhje të plotë me karakterin profesional të këtij programi.
	<i>Ev. 4.3. Programet mesimore te lendeve 2023-2024.</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës.	Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara nga studentët e këtij programi lehtësojnë procesin e integritetit të studentëve në tregun e punës, dhe ndjekjen e gjithë procedurave të nevojshme për licensimin e psikologëve sipas udhëzimeve të Urdhrit të Psikologut në Republikën e Shqipërisë. Kontaktet profesionale të vendosura gjatë zhvillimit të studimeve por edhe realizimit të praktikave profesionale lehtësojnë këtë proces më tej, sikundër u parashtrua edhe nga vetë studentët gjatë vizitës në institucion.
	<i>Ev. 4.1. Korniza konceptuale e programit te studimit.</i> <i>Ev. 4.4. Paketa e praktikës per programin e studimit</i>
Konkluzione	<i>Vlerësohet se struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese dhe rezultatet e nxënësve për Programin Master Profesional në Psikologji Ligjore. Programi pajis studentët me kompetenca profesionale në përputhje me kërkesat e tregut të punës për profesionin e psikologut ligjor si dhe mundëson ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm për licensim sipas</i>

	Udhëzimeve përkatëse nga Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Departamenti ka një rrjet të gjerë bashkëpunëtorësh në funksion të realizimit të programit të studimit, të cilët angazhohen në realizimin cilësor të gjithë aktivitetit mësimor dhe kërkimor si dhe praktikat profesionale. Gjatë vizitës në institucion u konstatua se njësia bazë mban kontakte të ngushta me alumni të këtij programi të cilët sigurojnë lidhjen me tregun e punës dhe japin feedback të vazhdueshëm në lidhje me përmirësime të mundshme të përmbajtjes së programit. <i>Ev. 4.16. Marreveshjet e nënshkruaja në funksion të praktikës profesionale</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni disponon politika në lidhje me përfshirjen e studentëve në procese konsultuese dhe vendim-marrëse, si dhe përmes aktiviteteve me studentët e diplomuar (Alumni). Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me studentët u konstatua sidomos përfshirja e vazhdueshme e studentëve të diplomuar në funksion të realizimit të programit të studimit. <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në	Departamenti mban kontakte me Urdhrin e Psikologut të Republikës së Shqipërisë, duke organizuar takime me përfaqësues të këtij institucioni, në funksion të përmirësimit të programit të studimit. Njësia bazë gjithashtu është angazhuar për përshtatjen dhe përmirësimin e programit në nivel ndërkombtar përmes certifikimit European Europsey.

bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	<i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>			
Konkluzione	<i>Njësia bazë ka politika për përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Përpjekje të vazhdueshme janë realizuar si në nivel kombëtar me Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë dhe ndërkombëtar përmes përshtatjes me standardet Europiane Europsy.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6

Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi I studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore ka të përcaktuar në rregulloren e vet objektivat kryesorë të studimit, në linjë me objektivat për kërkim-zhvillim të institucionit. Karakteri profesional i këtij programi studimi drejton fokusin drejt formimit të shprehive të kompetencave profesionale të studentëve por gjithmonë në kontekstin e zhvillimeve më të fundit me karakter kërkimor-shkencor në fushën e Psikologjisë Ligjore. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit.</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Njësia bazë administron dhe koordinon veprimtaritë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor (psh. Konferenca, simpoziume), në respekt të plotë të lirisë akademike të personelit akademik. Ajo bashkëpunim me strukturat e tjera në nivel institucion në drejtim të monitorimit dhe zhvillimit të veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore dhe veprimtarive të tjera ekstrakurrikulare në kuadër të programit të studimit dhe përtej. <i>Ev. 3.2. Strategjia e zhvillimit të departamentit.</i> <i>Ev. 3.3. Rregullore e departamentit.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe	Gjatë vizitës në institucion u konstatua se njësia bazë angazhohet gjerësisht në nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve në veprimtari

motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	ekstrakurrikulare, përfshi ëorkshpe, projekte, konferenca etj., në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Përvoja e studentëve si pjesë e implementimit të projekteve dhe aktiviteteve tregon se ata janë të përfshirë dhe kanë një rol aktiv në zhvillimin e iniciativave të projekteve të ndryshme.			
	<i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës.</i>			
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni përmes formave të ndryshme si granti për aktivitet shkencor (financim I konferencave apo aktivitetit kërkimor të stafit akademik), grant për mobilitete të stafit akademik dhe studentëve në institucione partnere ndërkombëtare, Granti I mbështetjes studentore për studentët me pamundësi ekonomike etj. Departamenti dhe institucioni në tërësinë e vet mbështet financiarisht proceset akademike dhe kërkimore-shkencore në të gjitha dimensionet e veta duke përfshirë si stafin akademik edhe studentët.			
	<i>Ev 2.8. Informacion për respektimin e lirisë akademike dhe të autonomisë organizative dhe financiare.</i>			
	<i>Ev. 2.34. Dokumenti për buxhetin FSHS.</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor. Institucioni ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm konkretë për mbështetjen financiare të gjithë aktivitetit mësimor dhe të kërkimit shkencor si për personelin akademik edhe për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të	Njësia bazë që ofron programin e studimit ka politika të mirëpërcaktuara që diktojnë format e bashkëpunimit me njësitë e tjera në kuadër të projekteve kërkimore-shkencore me funksion realizimin e objektivave të kërkimit shkencor. Gjatë takimit me stafin e angazhuar në këtë program studimi u paraqet evidencë për mbështetjen financiare në kuadër të aktiviteteve shkencore si konferenca shkencore apo pjesëmarrjen në aktivitete në kuadër të realizimit të projekteve kërkimore-shkencore. Përfshirja e

programit të studimit në kërkim shkencor.	studentëve në këto procese u identifikua gjithashtu si një pikë e fortë në kuadër të promovimit dhe mbështetjes së kërkimit shkencor. <i>Ev. 2.2. Strategjia e zhvillimit të FSHS.</i> <i>Ev. 3.2. Strategjinë e Zhvillimit të departamentit</i> <i>Ev.3.5. Strategjia për Zhvillimin e Programit</i> <i>Ev. 4.12. Lista e projekteve qe kane patur ndikim ne zhvillimin e programit te studimit.</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Njësia bazë bashkëpunon ngushtësisht me strukturat e tjera, duke ju përgjigjur kërkesave të tyre për staf të specializuar në përputhje me nevojat e projekteve të ndryshme kërkimore. Kërkesat mund të burojnë edhe nga vetë stafi akademik, institucione të tjera, ose partnerë ndërkombëtarë. Gjatë vizitës në institucion u identifikuan shembuj të praktikave të mira ku pedagogët dhe studentët përfshihen në projekte të përbashkëta me karakter kërkimor-shkencor, duke ofruar një mundësi unike për tu zhvilluar në këtë drejtim të rëndësishëm për karrierën e tyre në të ardhmen. <i>Ev. 4.7. Te dhenat e plota per kerkimin shkencor ne kuader te programit te studimit</i> <i>Ev. 4.7.1. Te dhenat te plota per kerkimin shkencor 2022-2023</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Departamenti I Pedagogjisë dhe Psikologjisë paraqiti evidencë për organizimin e një sërë veprimtarish shkencore ekstrakurrikulare, përfshi konferenca, leksione të hapura, vizita në institucione në nivel lokal, kombëtar ose ndërkombëtar. Këto aktivitete shkencore shërbejnë si një platformë për ndarjen e njohurive dhe për ndërveprimin me akademikë të tjerë dhe studentë nga universitete të tjera. Aktiviteti shkencor promovohet përmes publikimeve në revista shkencore, ëbsite të Fakultetit si dhe mediave sociale, duke i bërë këto rezultate të aksesueshme për publikun më të gjerë dhe duke kontribuar në rritjen e njohurive të përgjithshme. <i>Ev. 4.7. Te dhenat e plota per kerkimin shkencor ne kuader te programit te studimit</i> <i>Ev. 4.7.1. Te dhenat te plota per kerkimin shkencor 2022-2023</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon	Programi I studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore” formon profesionistë të fushës me aftësitë dhe kompetencat e

profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	duhura për tu përballur me tregun e punës në Shqipëri. Njësia bazë gjithashtu ka rritur përpjekjet në drejtim të zgjerimit të tregut të punës për këta studentë duke aplikuar për përafrim dhe unifikim me standardet Europiane të EuroPsy. Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës.			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Departamenti ka bashkëpunim të vazhdueshëm me Urdhrin e Psikologut, duke u vënë në dijeni mbi të rejat apo rekomadimet më të fundit për licensimin në këtë profesion. Ajo monitoron vazhdimisht ndryshimet në aktet ligjore apo rregulloret e reja të fushës që lidhen me licencën e profesionit, sidomos përsa I takon kompetencave apo standardeve përkatëse. Shembuj përfshijnë pjesëmarrjen në takime, seminare, dhe rrjete profesionale. Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Programi i studimit përputhet me aktet ligjore në vend për Profesionin e Rregulluar të Psikologut në Republikën e Shqipërisë duke mundësuar studentët që përfundojnë këtë program studimi të ndjekin procedurat e parashikuara për Licensim në këtë profesion. Përpjekjet në drejtim unifikimit të programit me standardet Europiane përmes Certifikimit EuroPsy përbëjnë gjithashtu një pikë të fortë duke zgjeruar mundësitë e studentëve për punësime edhe përtej Shqipërisë. Përmbushja e këtyre standardeve garanton cilësinë e programit në funksion të përgatitjes së studentëve për të qenë konkurrues në profesionin e tyre në të ardhmen. Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës			
Konkluzione	Departamenti ka politika të mirëpërcaktuara që diktojnë format e bashkëpunimit të brendshëm dhe të jashtëm në funksion të realizimit të objektivave të kërkimit shkencor. Departamenti bashkëpunon ngushtësisht me Urdhrin e Psikologut të Shqipërisë duke lehtësuar integrimin e studentëve në tregun e punës. Në mënyrë që studentët të jenë konkurrues jo vetëm në nivel kombëtar por edhe ndërkombëtar është punuar në drejtim të unifikimit të kurrikulës sipas standardeve EuroPsy.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies përshkruhen në Rregulloren e Programit të Studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore dhe përfshijnë: leksione, seminare, detyra kursi, prezantime, projekte kërkimi dhe praktika profesionale. Gjatë takimeve me pedagogët dhe studentët, ata konfirmuan të gjitha këto forma të transmetimit të dijeve, sipas lëndëve përkatëse. Pedagogët theksuan vecanërisht aspektet praktike në orët e seminarit përmes detyrave praktike që ata përdorin apo orëve të hapura me të ftuar specialistë të fushës. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit.</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me stafin akademik të angazhuar në programin e studimit, doli në pah larmishmëria e metodave të mësimdhënies që ata përdorin duke organizuar orët e mësimi sipas nevojave dhe nivelit të studentëve. Diskutimet në grup, role play si dhe analiza e rasteve studimore, japin larmishmëri dhe angazhojnë studentët në forma të ndryshme krahas mësimdhënies klasike përmes leksioneve. <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e	Institucioni mbështet përmirësimin e kompetencave të personelit akademik përmes 2 formave kryesore përfshir: aksesit në literaturë në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor

kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	(biblioteka online), dhe mobiliteteve në mësimdhënie me një mori institucionesh ndërkombëtare në kuadër të programeve Erasmus. <i>Ev. 4.11 Të dhënat për aktivitetet për kualifikimin e personelit akademik.</i> <i>Ev. 4.6. Të dhënat tabelore për personelin akademik.</i> <i>Ev. 3.5. Strategjia e zhvillimit të programit të studimit.</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik qartësisht zbaton qasjen mësimore me studentin në qendër duke përdorur metoda interaktive dhe bashkëkohore në funksion të përvetësimit të lëndëve përkatëse. Kjo qasje doli në pah si në takimet me pedagogët ashtu edhe me studentët, të cilët vunë në pah format në të cilat pedagogët e tyre nxisin mendimin kritik dhe diskutimin aktiv në klasë. Kualifikimi profesional i personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi, sikundër dëshmohet nga CV përkatëse, është një pikë e fortë në funksion të cilësisë së programit dhe kualifikimit të studentëve si profesionistë të ardhshëm. Një pjesë e konsiderueshme e profesorëve të angazhuar kanë dhënë kontributin e tyre në hartimin apo përmirësimin e kurrikulave, hartimin e manualeve, udhëzuesve apo politikave në fushën e psikologjisë ligjore dhe përtej. <i>Ev. 4.15. CV e personelit akademik dhe ndihmes akademik per programin e studimit.</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Njësia e sigurimit të cilësisë në bashkëpunim me koordinatoren e programit të studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore, organizon vlerësime periodike të cilësisë së mësimdhënies. Në këtë proces studentët vlerësojnë lëndët dhe pedagogët në mënyrë anonime dhe japin feedback-un e tyre në lidhje me format e mësimdhënies. <i>Ev. 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së</i> <i>Ev. 2.17. Raporte periodike NJSBC 2023, 2024.</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e	Njësitë të cilat janë përgjegjëse për monitorimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies përfshijnë: Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Njësinë për zhvillimin e kurrikulave. Studentët angazhohen në vlerësime periodike të

vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	programit mësimor dhe stafit akademik, mbi bazën e të cilave hartohen raporte të cilat lejojnë një vështrim të përgjithshëm të gjendjes së programit të studimit, dhe sugjerojnë ndryshime të nevojshme në funksion të programit të studimit. Gjetjet e raporteve publikohen dhe diskutohen me stafin drejtues gjithmonë në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së performances, njësia bazë gjithashtu organizon trajnime për stafin e ri akademik në funksion të përshtatjes së tyre me standardet e cilësisë. <i>Ev. 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së</i> <i>Ev. 1.14. Paketa e instrumenteve të cilësisë</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>		
Konkluzione	<i>Njësia bazë garanton një proces mësimdhënie cilësor, përmes një stafi akademik të kualifikuar e me përvojë. Mësimdhënia me në qendër studentin përfshin aftësimin e tyre profesional duke përdorur praktikën më të mira bashkëkohore. Cilësia e mësimdhënies monitorohet vazhdimisht nga njësitë përkatëse dhe stafi akademik angazhohet në trajnime të vazhdueshme.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore” përcakton kriteret dhe format e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Studentët njihen me format e vlerësimit përmes syllabuseve (nga vetë pedagogët e lëndëve), sistemin e-studentëve (përmes të cilit marrin vlerësim të personalizuar) si dhe sekretarisë mësimore. Gjatë vizitës në institucion, studentët u shprehën se kriteret dhe mënyrat e vlerësimit ishin të qarta dhe transparente. Ata theksuan rolin e rëndësishëm që kanë vetë pedagogët dhe koordinatorja e programit në këtë proces.

	<i>Ev. 4.3.1 Programet mesimore te lendeve 2022-2023</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Si pedagogët edhe studentët konfirmuan se në fillim të çdo semestri studentët informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive nga pedagogu i lëndëve përkatëse etj. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe përvec provimeve përfshin detyrat e kursit dhe angazhimin në seminare. Ndarja në komponentë, vlerësimin e bën këtë të fundit më objektiv, dhe nxit të mësuarit gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të lëndës. <i>Ev. 4.3.1 Programet mesimore te lendeve 2022-2023</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Format e vlerësimit në të gjitha lëndët ndjekin parimin e vlerësimit të vazhduar duke ndarë vlerësimin në komponentë si angazhimi në seminar (10 pikë), testi i ndërmjetëm (20 pikë), detyra e kursit/detyrat praktike (20 pikë) dhe testi final (50 pikë). Gjithashtu tezat e provimit përfshijnë diversitetet në format e kontrollit të dijeve duke përfshirë grup pyetje për kontrollin e njohurive, grup pyetje analizuese dhe grup pyetje zhvilluese, duke i dhënë në këtë mënyrë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara në varësi të stilit personal të të nxënit. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit te studimit</i> <i>Ev. 4.3.1 Programet mesimore te lendeve 2022-2023</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>			
Konkluzione	<i>Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore si dhe cdo syllabus, përfshin kriteret dhe mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive bazuar mbi parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të Provimit përfundimtar, Provimit të ndërmjetëm, dhe pjesëmarrjes në seminare, detyra/projekte kursi. Në fillim të çdo semestri studentët informohen në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive nga pedagogu i lëndëve përkatëse.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Rregullorja e Programit të Studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore përcakton si elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm: provimet (përfshi provimin e ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar), detyrat e kursit/detyrat praktike dhe nivelin e aktivizimit në seminare. Vlerësimi i vazhduari i studentëve përcaktohet në syllabusin e lëndëve dhe mundëson një vlerësim më objektiv të tyre gjatë gjithë lëndës. <i>Ev. 4.3.1. Programet mësimore të lëndëve MP Ligjore 2022-2023.</i> <i>Ev. 4.3. Programet mësimore të lëndëve MP Ligjore 2023-2024.</i> <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Institucioni disponon platformën elektronike e-student përmes të cilës studentët njihen me vlerësimin dhe në vijim mund ta ankimojnë atë. Gjatë vizitës studentët konfirmuan funksionalitetin e platformës si dhe përdorimin e saj. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Pedagogu bën vlerësimin përfundimtar të lëndës në përputhje me syllabusin, duke marrë parasysh të gjithë komponentët e vlerësimit: aktivizimin në seminare, detyra kursi/detyra praktike dhe provime (të ndërmjetme/përfundimtare). Provimet zhvillohen me sekretim të tezave për të ruajtur anonimitetin e studentëve. Sekretaria mësimore bën heqien e sekretimit të tyre dhe nxjerrjen e rezultatit për secilin student. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i	Gjatë takimeve me pedagogët dhe studentët u konfirmua se feedback-u në lidhje me provimet është një procedurë që vihet konkretisht në zbatim. Në raste ankimimi pedagogët diskutojnë me studentët tezën e provimit, dhe celësin përkatës, duke

nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	evidentuar edhe problematika që mund të jenë konstatuar gjatë vlerësimit. Në këtë mënyrë studenti vëren në mënyrë transparente procesin e korrigjimit cka e ndihmon për përmirësim në vlerësimet e tjera në të ardhmen. <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregullorja e Departamentit dhe Programit të studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore parashikon një procedurë të qartë në lidhje me shmangien e plagjiaturës/kopjimit në provime dhe detyra kursi. Gjatë takimit me studentët ata treguan dijeni në lidhje me seriozitetin e kësaj c'ështëje. Provimet janë objekt monitorimi të ngushtë, c'ka redukton shanset për kopjim. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rregullorja e Programit të Studimit qartëson format dhe procedurat e vlerësimit, shpalljes së rezultateve dhe ankimimit. Transparenca në vlerësim për secilën lëndë monitorohet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë gjatë raportimeve periodike. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore studentët njihen me vlerësimin në lëndët përkatëse, I cili bëhet përmes sistemit elektronik në mënyrë individuale. Rregullorja gjithashtu parashikon kërkesën për rishikim të vlerësimit, cka u konfirmua edhe nga studentët si procedurë ekzistuese në institucion. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas Rregullores së Programit të Studimit, studenti njihet me rezultatet e provimit përmes sistemit elektronik ose sekretarisë mësimore dhe më pas ka të drejtën e ankimimit sipas një procedure specifike. Në përputhje me Rregulloren, rivlerësimi realizohet nga një komision i posaçëm I ngritur për këtë qëllim. Gjatë takimit me pedagogët dhe studentët u konstatua se ata ishin në dijeni të procedurës, pavarësisht se pranuan se nuk

	kishte raste konkrete ankimimi për programin specifik të studimit. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit. Rregullorja e Programit të Studimit përcakton qartë procedurat e ndjekura për vlerësimin e vazhduar të studentit, vënien në dijeni për rezultatet, dhe shqyrtimin e kërkesave për rivlerësim nga ana e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Përmbytja e programit Master Profesional në Psikologji Ligjore pajis studentët me njohuri të thelluara në fushën e psikologjisë ligjore duke I dhënë njëkohësisht mundësi studentëve të zgjerojnë njohuritë në një gamë të profileve interdisiplinare përfshi fushën klinike dhe atë juridike. Programi gjithashtu ofron një përvojë të pasur praktike si përmes orëve mësimore ashtu edhe përmes realizimit të praktikës profesionale duke realizuar më së miri objektivat formues si program profesional. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i> <i>Ev. 4.3. Programet mesimore te lendeve 2023-2024</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Programi i studimit Master Profesional në Psikologji ligjore përfshin lëndët plotësuese të Kategorisë D të cilat kanë karakter ndërdisiplinor. Si stafi akademik ashtu edhe studentët konfirmuan format e ndryshme të mësimdhënies. Shembuj përfshijnë punën në grupe, prezantimet, debatet apo role play nxisin zhvillimin e aftësive të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit, komunikimit dhe ndërveprimit. <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i> <i>Ev. 4.3. Programet mesimore te lendeve 2023-2024</i>

Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Raporti i punës semestrale analizohet nga ana e cdo pedagogu në përfundim të lëndës së tij duke përfshirë elementë të mësimdhënies, mësimnxënies, kërkimit shkencor etj. Analiza vjetore vë në pah çështjet kryesore të cilat mund të jenë evidentuar në proces. Gjithashtu gjatë orëve të fundit të mësimin, studentët dorëzojnë detyrat e kursit, punët e laboratorëve, apo zhvillojnë seanca përmbledhëse ushtrimesh, përmes të cilave testojnë njohuritë e marra dhe vetëvlerësojnë përgatitjen e tyre përpara provimit përfundimtar. <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i> <i>Ev. 1.13. Manuali i vlerësimit të performancës së personelit akademik i UT-së.</i> <i>Ev. 2.16. Analizë vjetore e punës së Fakultetit të Shkencave Sociale 2021-2022, 2022-2023</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia në programin e studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore ndërthur orët teorike të leksioneve me elementët praktikë gjatë seminareve (role-play, punë grupi, debate etj). Praktika mësimore realizohet në bashkëpunim me institucionet partnere të Universitetit, përfshi Urdhrin e Psikologut, Institutin Shëndetësor të Veçantë për të Burgosurit, IEVP Ali Demi, IEVP Mine Peza, IEVP Jordan Misja, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, Qendra për Shërbime Psiko-Ligjore "Family" etj. Në këtë kuadër studentët pajisen me kompetenca profesionale, të cilat shërbejnë si bazë drejt profesionit të ardhshëm si psikolog ligjor. Gjatë vizitës në institucion studentët theksuan si pikë të fortë aspektin praktik të lëndëve si dhe kontaktet me personalitete të fushës të cilët ftohen në auditor në kuadër të leksioneve të hapura apo ëorkshopeve. Së fundmi ata theksuan mundësitë që krijohen për ta si punonjës të ardhshëm në këto institucione, duke u vënë në kontakt të drejtpërdrejtë me punëdhënësit e ardhshëm. Pavarësisht partneriteteve të shumta në nivel kombëtar, mobiliteti i studentëve të këtij programi në nivel ndërkombëtar (psh. Përmes projekteve Erasmus) është ende i kufizuar (2 shembuj gjatë vizitës), dhe institucioni duhet të rrisë përpjekjet në këtë drejtim. <i>Ev. 4.16. Marreveshjet e nënshkruara në funksion të praktikës profesionale</i>

	<i>Ev. 4.3.1. Programet mësimore të lëndëve MP Ligjore 2023-2024.</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Departamenti realizon orë të hapura, Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë angazhohet gjerësisht në aktivitete me natyrë trajnuese apo kërkimore-shkencore si konferenca, projekte të mobilitetit dhe kërkim-zhvillimit, simpoziume, apo leksione të hapura. <i>Ev. 4.11. Te dhenat per kualifikimin dhe kerkimin shkencor te personelit akademike ne 5 vitet e fundit</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Gjatë takimeve me stafin pedagogjik u theksua se lidhja e departamentit me tregun e punës siguron përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore që kanë aplikim praktik dhe ndihmojnë në zhvillimin e ekspertizës së studentëve. Inkurajimi dhe mbështetja për publikimin e rezultateve të hulumtimeve në konferenca të ndryshme shkencore dhe revista të specializuara ndihmon në ndarjen e dijes dhe krijimit të lidhjeve të reja. Gjithsesi duke qenë se ky program studimi ka karakter profesional, aspekti kërkimor-shkencor nuk merr rëndësi qëndrore. <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës.</i>			
Konkluzione	<i>Programi Master Profesional në "Psikologji Ligjore" pajis studentët me aftësi e kompetenca të psikologut ligjor përmes aspekteve praktike të lëndëve, profesionistëve të ftuar në auditor si dhe praktikës profesionale të realizuar në një larmishmëri institucionesh partnere. Në përfundim të studimeve studentët fitojnë kompetenca për të punuar në profesionin e psikologut ligjor në të ardhmen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para	Në përfundim të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin Master Profesional në "Psikologji Ligjore". Diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome ose përmes provimit të formimit të përgjithshëm teorik.

realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Rregullorja e Programit të studimit si dhe Paketa për punimin e diplomës, qartësojnë detyrimet përmbyllëse të studentit, të drejtat e detyrimet e diplomantëve, si dhe rregullat për organizimin e procesit. Koordinatorja e Programit informon paraprakisht studentët në lidhje me procesin si dhe gjithë hapat e nevojshëm për tu ndjekur. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i> <i>Ev. 4.5 Paketa për punimin e diplomës</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë asiston studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzimet dhe materialet e nevojshme në funksion të mbrojtjes së diplomës. Studentët informohen që prej fillimit të semestrit të parë, në lidhje me procedurat e diplomimit nëpërmjet tezës së diplomës. Njësia bazë përcakton udhëheqësit për studentët të cilët mund të diplomohen me mbrojtje teze diplome. Mbrojtja e diplomës ka një procedure që e lehtëson punën e studentit në drejtim të përzgjedhjes së pedagogut udhëheqës sipas profilit të temës dhe monitorimin e punës përmes seancave të konsultimit që janë të detyrueshme nga studenti për t'u ndjekur përgjatë gjithë procesit. Departamenti monitoron zbatimin e procedurës. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i> <i>Ev. 4.5 Paketa për punimin e diplomës</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Njësia bazë ngre një komision shkencor me jo më pak se 3 (tre) anëtarë, i cili është përgjegjës për të gjitha procedurat që lidhen me diplomimin e studentëve që përmbushin detyrimet përmbyllëse me mbrojtje teme diplome. Mbrojtja përpara komisionit është e hapur dhe studenti ka të drejtë të referojë punimin e tij, e më pas tu përgjigjet pyetjeve të komisionit. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i> <i>Ev. 4.5 Paketa për punimin e diplomës</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve,	Udhëheqësi i diplomës ofron mbështetjen e duhur akademike dhe konsulencën e nevojshme që t'i mundësojë kandidatit të arrijë standarde të larta të punimit. Disa momente kyce gjatë procesit përfshijnë ndihmën për formulimin e titullit të punimit, për përgatitjen e propozimit dhe të platformës së punimit, rekomandimin e literaturës dhe të burimeve të tjera të informacionit, konsulencën për organizimin e shënimeve dhe

përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	përgatitjen e punimit. Udhëheqësi e ndihmon studentin të përmirësojë stilin e të shkruarit, dhe ka përgjegjësinë të vetëdijësojë studentin për rrezikun e plagjiaturës. Takimet kuantifikohen në 20 orë në total gjatë të cilave udhëheqësi monitoron punën e studentit dhe i kërkon studentit të paraqesë një raport të shkruar. <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit MP Ligjore.</i> <i>EV. 4.5 Paketa për punimin e diplomës</i>
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqësi i diplomës përmes seancave të konsultimit individual i ofron mundësi studentit të ndjekë kriteret në përcaktimin e metodave kërkimore që i lejojnë të mbledh, të administrojë dhe përpunojë të dhënat në mënyrë shkencore. Roli i udhëheqësit fokusohet në mbështetjen dhe ndihmën e studentit që të njoh dhe respektojë kriteret për realizimin e një punimi shkencor origjinal. Aksesi i studentit në mjediset jashtë institucionit, për qëllime si mbledhja e të dhënave facilitohet përmes marrëveshjeve të shumta të bashkëpunimit në funksion të programit të studimit (shemb. Instituti Shëndetësor i Veçantë për të Burgosurit, IEVP Ali Demi, IEVP Mine Peza, IEVP Jordan Misja, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, Qendra për Shërbime Psiko-Ligjore "Family" etj. Së fundmi, aksesi në biblioteka online mundëson shfrytëzimin e literaturës më të fundit në funksion të ngritjes së një punimi kërkimor cilësor. <i>Ev. 3.21. Tabel permbledhese me institucionet bashkepunuese per programin e studimit dhe praktiken profesionale.</i> <i>Ev. 4.5. Paketa e punimit te diplomes per programin e studimit.</i> <i>Ev. 2.25.1. Të dhëna të plota për platformat on-line tabela 17</i> <i>Ev. 2.25. Të dhëna për bibliotekën</i>
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Rregullorja e Programit të studimit përcakton vlerësimin me notë të studentit në përfundim të mbrojtjes së diplomës para komisionit. Studentët që nuk vlerësohen me notë kaluese kanë mundësinë e riparimit të punimit. Vlerësimi përfundimtar bëhet mbi bazën e pikëve të grumbulluara dhe përqindjeve përkatëse nga nota A(katër) deri në 10 (dhjetë). <i>Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit</i>

Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomë, listë notash dhe suplementin e diplomës për programin e studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore. Me kërkesë të studentit, atij mund ti vihet në dispozicion edhe një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. <i>Ev. 3.8. Shkresa QSHA për rregjistrimin e formës së diplomës.</i> <i>Ev. 3.9. Shkresa përcjellëse QSHA për kodifikimin e programit Master Profesional në Psikologji Ligjore.</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Pas përfundimit të studimeve institucioni ruan një kopje të dokumentacionit të studentit për një periudhë pa afat. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të Ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, nevojave institucionit, apo kërkesës nga studentët. <i>Ev. 1.8. Rregullore e UT për mbrojtjen dhe përpunimin e të dhënave personale</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse, e cila përcaktohet në Rregulloren e Programit të Studimit. Studenti asistohet në çdo hap në realizimin e punimit të diplomës përmes Manualit përkatës si dhe kontaktit të ngushtë me udhëheqësin shkencor. Në përfundim të studimeve institucioni pajis studentin me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga MAS.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfutimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose	Praktika profesionale në funksion të programit të studimit realizohet në bashkëpunim me një sërë institucioneve të cilat mund të shërbejnë për punësimin e këtyre profesionistëve në të ardhmen. Lista e institucioneve është mjaft e gjatë, duke ju dhënë

jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	studentëve shumëllojshmëri zgjedhje. Shembuj përfshijnë: Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve që përfshin një sërë institucionesh nën varësi si: Instituti Shëndetësor i Veçantë për të Burgosurit, IEVP Ali Demi, IEVP Mine Peza, IEVP Jordan Misja si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë, Qendra për Shërbime Psiko-Ligjore "Family": Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës etj. <i>Ev. 4.16. Marrëveshjet e nenshkruaja ne funksion te praktikës profesionale</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Paketa e praktikës përcakton procedurën dhe format e zhvillimit të praktikës profesionale nëpër institucionet me të cilat UT ka marrëveshje bashkëpunimi. Gjatë vizitës në institucion studentët shprehen se Praktika profesionale përbën në fakt një nga pikat më të forta të programit, duke i pajisur ata me njohuri dhe kompetenca profesionale të nevojshme për tregun e punës. <i>Ev. 4.5 Paketa e praktikës</i> <i>Ev. Minutat: Shënime gjatë vizitës</i>
Kriteri 3. Praktikant profesional, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Kurrikula e programit Master Profesional në Psikologji Ligjore përcakton Praktikën Profesionale në masën 10% të krediteve të programit, pra 6 ECTS. Praktika e realizuar në institucionet me të cilat UT ka marrëveshje bashkëpunimi, përmban formatet e raportimit dhe vlerësimit nga udhëheqësit e praktikës. Në këtë mënyrë i gjithë procesi është i dokumentuar dhe vlerësimi përfundimtar i studentit realizohet duke pasur parasysh gjithë mbarëvajtjen e procesit. <i>Ev. 4.5. Paketa e praktikës për programin e studimit.</i> <i>Ev. 4.16. Marrëveshjet e nenshkruaja ne funksion te praktikës profesionale</i>
Konkluzione	<i>Institucioni realizon praktikant profesional në funksion të programit të studimit përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit me një sërë institucionesh të tjera. Paketa e praktikës përcakton procedurën dhe format e zhvillimit të praktikës profesionale nëpër institucionet me të cilat UT ka marrëveshje bashkëpunimi.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Zyra e Burimeve Njerëzore në FSHS ishte struktura përgjegjëse për mbledhjen, për ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi. Personali akademik dhe ndihmës akademik kanë dosjet e tyre personale me të dhëna të plota. Nga CV-të (Ev. 4-16, Cv e PAE/PAK) e shqyrtuara rezulton se personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ata kanë kualifikimin akademik në përputhje me fushat e programit të studimit, si për drejtimin psikologji kliniko-ligjore, ashtu dhe në fushat specifike të saj, si juridikut, me kualifikimet dhe ekspertizat përkatëse (Ev. 4.3.1. Programet mësimore të lëndëve). GVJ konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme i angazhuar në realizimin e programit të studimit MP në “Psikologji Ligjor” për vitin akademik 2023-2024 është; Prof.Dr. 1; Prof.Asoc.Dr. 4; Dr. 3 dhe Msc 1 (Ev.4-17, aneks i tabelave, tabela nr.2).

	<i>Të dhënat për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik (PAE dhe PAK) për programin e studimit, Master Profesional në "Psikologji Ligjore", sipas viteve akademike, paraqiten si më poshtë:</i> <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik</th><th colspan="2">2022-2023</th><th colspan="2">2023-2024</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Prof.Dr.</td><td>1</td><td>-</td><td>1</td><td>-</td></tr><tr><td>Prof. Asoc.</td><td>3</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Dr./PhD.</td><td>3</td><td>-</td><td>3</td><td>1</td></tr><tr><td>MSc.</td><td>2</td><td>2</td><td>1</td><td>2</td></tr><tr><td>Totali</td><td>9</td><td>2</td><td>9</td><td>3</td></tr></table>	Kualifikimi i stafit akademik	2022-2023		2023-2024		PAE	PAK	PAE	PAK	Prof.Dr.	1	-	1	-	Prof. Asoc.	3	-	4	-	Dr./PhD.	3	-	3	1	MSc.	2	2	1	2	Totali	9	2	9	3
Kualifikimi i stafit akademik	2022-2023		2023-2024																																
	PAE	PAK	PAE	PAK																															
Prof.Dr.	1	-	1	-																															
Prof. Asoc.	3	-	4	-																															
Dr./PhD.	3	-	3	1																															
MSc.	2	2	1	2																															
Totali	9	2	9	3																															
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	GVJ referuar informacionit të deklaruar (Ev.4-17, Aneks tabelat, tab. nr. 12.1-12.2 për ngarkesën mësimore) konstaton se raporti i ngarkesës mësimore për programin e studimit është në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. (Udhëzimi nr.29, datë 10.09.2018 Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personalit akademik në IAL). Personeli akademik efektiv (PAE) mbulon më shumë se 70% të garkesës të programit të studimit. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi janë lektorëve me gradë dhe tituj shkencore, konkretisht për vitin akademik 2023-2024: Prof.Dr - 1; Prof.Asoc. – 3; Dr. – 3 dhe në Dr. (proc) – 4, dhe një –Msc.																																		
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Lidhur me personelin akademik të angazhuar në programin e studimit konstatohet se ka të dhëna që dëshmojnë stabilitet dhe qëndrueshmëri. Bazuar në dokumentacionin e UT mbi punësimin, (Ev 1.12. Manual për punësimin e personelit UT) personeli akademik punësohet me kontratë të pacaktuar në linjë me gradat shkencore dhe titujt akademik që ato kanë në bazë të cilës ato nënshkruajnë dhe kontratën e punës. (Ev. 2.22. Udhëzues për dosjen e pedagogut)																																		
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që	Duke iu referuar dokumentacionit (Ev 1.12. Manual për punësimin e personelit UT) si dhe nga të dhënat e marra në faqen zyrtare të FSHS (https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/struktura-drejtuese-akademike-dhe-administrative/personeli-akademik), institucioni ndjek një procedurë rekrutimi për personelin akademik																																		

garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	transparente dhe të bazuar në meritat individuale. Personeli akademik përzgjidhet duke u bazuar në : Identifikimin e nevojave për staf akademik dhe kriteret e pranimit; Shpallja e vendeve të lira; Shqyrtimi dosjeve dhe intervistimi; Punësimi dhe procedurat administrative. UT shpall konkursin për vende të lira punë, referuar kërkesave të Departamentit, sipas nevojave të evidentuara si dhe kriteret përcaktohen nga departamenti dhe miratohen nga Dekanati. Njoftimi shpallet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Administratës Publike, në faqen zyrtare të UT-së. Bazuar në rregulloren e UT për përzgjedhjen e pedagogëve me propozim të Dekanit dhe miratim të Rektorit ngrihet një komision ad hoc i përbërë nga pedagogë të brëndshëm dhe me përvojë të departamenteve dhe një përfaqësues i zyrës së burimeve njerëzore. Zyra e Burimeve Njerëzore është njësi që ndjek procedurat e punësimit për personelin me kohë të plotë, të pjeshme si dhe atë administrativ, të cilat ishin konform akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe rregullores për burimet njerëzore.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit akademik, ndihmës akademik për realizimin sa më profesional dhe efektiv në shërbim të realizimit të procesit mësimor si në aspektin teorik dhe atë praktik. Bazuar në strukturën akademike dhe ndihmës akademike dhe të infrastrukturës në shërbim të këtij programi, (Ev 2.5. <i>Struktura organizative FSHS.pdf</i> dhe Ev.2.6 <i>Struktura e programeve të studimit të FSHS</i>). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se FSHS plotëson më së miri nevojat e studentëve të këtij programi studimi. Programi i studimit nuk ka orë laboratorike.
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të	Referuar RVB, por dhe në takimin me Dekanin e FSHS dhe Përgjegjësin e Departamentit të Psikologjisë dhe Pedagogjisë, GVJ konstatoi se UT nëpërmjet strukturave të tij si dhe nëpërmjet Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë dhe Zyrës të Burimeve Njerëzore garanton menaxhimin efektiv të personelit të angazhuar në programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore”. Zyra e Burimeve Njerëzore është njësi që ndjek procedurat e rekrutimit të marjes në punë, të trajtimit të personelit akademik dhe ndihmës/akademik. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për një gamë detyrash si: hartimin, plotësimin dhe ruajtjen e dokumentacionit e procesit mësimor lidhur me studentët dhe provimet, realizon procedurat e pranimit të kandidatëve që do studiojnë në këtë program studimi dhe është përgjegjëse për ndjekjen e procesit të matrikullimit për të gjithë

personelit ndihmës dhe administrativ.	studentët, kontrollon e mban përgjegjësinë për hedhjen e të dhënave në Regjistrin themeltar, Regjistrin e arritjeve akademike dhe Regjistrin e lëshimit të diplomave.
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Të dhënat e vëna në dispozicion për këtë program studimi tregojnë se FSHS siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, në funksion të realizimit të programit të studimit Master Profesional në "Psikologji Ligjore". Kapacitetet e UT-së dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të tjera (Ev. Marrëveshjet) mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e praktikës profesionale dhe në funksion të punimit të temës së diplomës. Në kuadër të procesit të kryerjes së praktikës profesionale, janë angazhuar maksimalisht në realizimin e marrëveshjeve me organizata të ndryshme në nivel vendor apo qendror si Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve që përfshin një sër institucionesh nën varësi të saj; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tirana, Qendra të ndryshme. etj.. Departamenti përgjegjës për këtë program studimi ka hartuar dhe procedurat e praktikës profesionale. Bazuar në takimet apo informacione të marra në institucion, GVJ konstatoi përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. FSHS ka angazhuar personel akademik dhe kërkues, personel ndihmës akademik dhe personel administrative. Personeli akademik me tituj akademik, "Profesor dhe Profesor i Asociuar" dhe gradë shkencore "Doktor i Shkencave" (Ev.4-16 CV e personelit akademik dhe Ev.4.3.1 Syllabuset), janë angazhuar në role të ndryshme si atë të kordinatorit, udhëheqësit shkencor, supervizorit të praktikës duke mbikëqyrur një sër veprimtarish në funksion të nevojave të këtij programi studimi.
Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë në funksion të realizimit të objektivave formuese të programit të studimit MP në "Psikologji Ligjore", kishte nënshkruar një sër marrëveshjesh institucionale (Ev. Marrëveshjet bilaterale) të cilat janë shfrytëzuar për qëllime të praktikave profesionale, aktivitete të tjera me natyrë ekstrakurrikulare orë të hapura me lektorë të ftuar, takime pune dhe mundësive për mobilitet të stafit dhe studentëve në të cilat janë angazhuar anëtarë të stafit akademik dhe profesionist të institucioneve me të cilat bashkëpunon. (Rubrika galeri & evente).

	Këto marrëveshje me disa institucione kyçe për profilin e psikologut ligjor janë shfrytëzuar për nevojat e studentëve dhe të programit studimit.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se personeli akademik që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit të studimit, duke garantuar standarde të mësimëdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	UT është një institucion i akredituar, i cili siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse (Ev. 2.32. <i>TË dhëna për infrastrukturën</i>). Procesi mësimor për këtë program studimi ushtrohet në godinën e FSHS, duke përmbushur kriterin nga pikëpamja e sipërfaqes dhe mjediseve të nevojshme dhe të përshtatshme mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. Mjediset e godinave plotësojnë normativat teknike të ndriçimit natyral (Ev. 2-23 <i>Raporti i ekspertit për infrastrukturën</i>). Personeli akademik disponon zyra të veçantë, të cilat shërbejnë për punë të pavarur dhe veprimtari të tjera kërkimore-shkencore.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e	FShS dhe Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë që ofrojnë programin e studimit disponojnë auditore për leksione/seminare, salla kompjuteri dhe laborator, sallë interneti, të pajisura me infrastrukturën bazë mësimore. Zyrat që kryejnë funksionet mbështetëse, të tilla si Burimet Njerëzore, IT, Biblioteka janë të akomoduar në sallat e tyre përkatëse të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për një funksionim normal të aktivitetit të tyre. Procesi mësimor në Programin e studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore” ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra dhe një sallë laborator të cilat kanë

teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënit. Mjediset mësimore (klasa, studio e mjedise të tjera) janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, duke mundësuar realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Të gjitha sallat e leksioneve dhe seminareve ku realizohet ky program studimi ishin të pajisura me videoprojektor, laptop, ëhiteboard, platform online dhe të gjitha mjetet e tjera logjistike. Laboratori i teknologjisë së informacionit, i cili është në funksion të zbatimit të këtij program studimi, ishte i kompletuar me pajisje kompjuterike (video-projektor dhe kompjutera të lidhur me internet).
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Nga vëzhgimi i mjediseve në institucion, rezulton se mjediset mësimore të ofruara nga FSHS janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore (Ev.2-32. Të dhëna për infrastrukturën). Programi i studimit realizohet në 1 godinë ku sigurohet hapësirë të përshtatshme, të tilla si: laboratore, klasa, zyra dhe mjediset të tjera me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni, siç janë: videoprojektorët, kompjuteret dhe interneti për të realizuar programin e studimit. Mjediset mësimore, auditorët, janë të mirëpajisura me tabela dhe në çdo klasë ka të instaluar pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit (si PC, videoprojektor, TV, kamera dixhitale dhe pajisje CD). Rrjeti i internetit është shtrirë në të gjithë mjediset mësimore. Mjediset mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit dhe që garantojnë realizimin e procesit mësimor dhe se 100% e hapësirës anësore të të gjitha sallave ku realizohet mësimi është me dritare, duke garantuar ndriçim natyror dhe ajrosje të mjaftueshme.
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Programi i studimit Master Profesional në Psikologji Ligjore si një fushë e shkencës së aplikuar (psikologji) realizohet nëpërmjet seminareve ose në mënyrë më të drejtpërdrejtë nëpërmjet praktikës profesionale në institucione të ndryshme, dhe si e tillë ndikimi laboratorik nuk është aq i rëndësishëm sa ndikimi praktik. Megjithatë institucioni disponon pajisje dhe aparatura të cilët vihen në përdorim të studentëve sipas kërkesave të tyre për realizimin e detyrave të kursit ose edhe për aktivitete të tjera jashtëshkollore dhe aktivitete të ndryshme studentore. Laboratori i teknologjisë së informacionit është në funksion të zbatimit të këtij

	program studimi, është i kompletuar me pajisje kompjuterike, të aksesueshëm për të gjithë studentët. Laboratori ishte në dispozicion të studentëve për të realizuar detyrat, disa orë edhe për mësimdhënie edhe për takimet apo projektet e ndryshme studentore. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në një sër aplikacionesh dhe programesh teknologjike si E-student, Teams, Jetstore, Classroom, ESC apo dhe Office 365 etj.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Referuar planit mësimor (E. 4.17 tabelat përmbledhëse) orët e formimit praktik janë 6 kredite me 150 orë praktikë profesionale; Departamenti me anë të marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit realizon praktikën, në institucione të lidhura me profilin ligjor si Drejtorinë e Përgjithshme e Burgjeve që përfshin një sër institucionesh nën varësi si: Instituti Shëndetësor i Veçantë për të Burgosurit, IEVP Ali Demi, IEVP Mine Peza, IEVP Jordan Misja si dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë, Tirana, Qendra për Shërbime Psiko-Ligjore "Family"; Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës etj (Ev. 4.16. Marrëveshjet biletarale) për zhvillimin e praktikave profesionale për studentët e këtij programi. Nga takimi në institucion, GVJ u informua se studentët kryesisht për realizimin e praktikës akomodohen në institucionet e përzgjedhura prej tyre dhe vihen nën mbikqyrje nga një psikolog i licencuar i cili ushtron aktivitet në këto institucione, pasi ky është një profesion i licencuar dhe ka udhëzime përkatëse nga Urdhri i Psikologut. Është pikërisht ky psikolog mbikqyrës i cili më pas realizon dhe një vlerësim mbi ecurinë e praktikës mësimore në institucion. E gjithë procedura e praktikës është e mbështetur dhe në dokumentacionin përkatës të miratuar në Departament.			
Konkluzione	Procesi mësimor në Programin e studimit Master Profesional në "Psikologji Ligjore" ka në dispozicion salla leksioni, seminari, zyra dhe një sallë laboratorit të cilat kanë infrastrukturën e duhur për një proces normal të të nxënësve. Departamenti me anë të marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit realizon praktikën, në institucione të lidhura me profilin ligjor të programit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse kryesisht vihej në dispozicion të studentëve nëpërmjet bibliotekës si dhe nëpërmjet përdorimit të platformës Teams, ku pedagogu krijon klasën virtuale. Studentët kanë dy biblioteka, një në FSHS dhe tjetra në mjediset e rektoratit të UT-së. Në FSHS ndodhet një Bibliotekë e cila ka një fond librash, në gjuhën shqipe dhe gjuhë të huaj, duke përfshirë edhe tituj të fushave të ndryshme. Numri i titujve fizikë në fond: 7000, numri i ekzemplarëve: 25.000 (nuk përfshihen masterat (4500); artikujt shkencorë (mbi 4000) dhe librat elektronikë (mbi 30. 000). Numri i teksteve mësimore: 2500 tekste. Investimet për shtim literature fizike është bërë duke shkruar në 234 libra të rinj blerje për vitin 2023-2024 (Ev.4-10 Të dhënat në bibliotekë). Përsa i përket literaturës në formë elektronike rezultojnë se për nevojat e studentëve janë vënë në dispozicion një sër platformash elektronike si ERIC, MEDLINE, Ebsco Open Dissertation dhe DOAJ (Directory of Open Access Journals), APA, Proquest, Scopus free, Cobbis etj, të cilat mund të lehtësojnë aksesin në burime bibliografike të viteve të fundit.
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë si njësia përgjegjëse, ka përcaktuar kriteret që duhet të plotësojnë tekstet që do të renditen në literaturën bazë të detyruar të miratimit në departament. Duke iu referuar dokumentacionit të shqyrtuar si dhe shënimeve në institucion rezultojnë se përditësimi i titujve të librave në bibliotekë përditësohet çdo vit. Referuar burime të literaturës online aksesohen lirisht nga stafi dhe studentët e këtij programi studimi.
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni vënë në dispozicion të studentëve bibliotekën qendrore të FSHS-së e cila është në dispozicion të studentëve, me një hapsirë prej 300 m² me 48 vende leximi dhe një mjedis për shfrytëzimin e bibliotekës on-line. Në të gjenden dy salla: sala me fond të hapur, ku përveç fondit të literaturës ofohet dhe internet, fondi i librave i hapur dhe mundësohen lirshëm nga studentët; dhe sala me fond të mbyllur për përdorim literature vetëm në sallën e leximit. Gjithashtu është në funksionim biblioteka në Godinën e Rektoratit të UT-së, e cila mbulon një sër shërbimesh si arkivim të çdo kopje të libri të ri fizik që hyn, dixhitalizim të skedarëve,

	arkivim të punimit të diplomës, me një fond prej 8000 titujsh në huaj dhe në shqip. Biblioteka është lehësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe stafi akademik, numri i të anëtarësuarve fizikë është afërsisht 1100.
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Numri i kopjeve fizike në bibliotekën e FSHS është (<i>Ev.2-25 Të dhëna për bibliotekën</i>). Numri i librave që i shërbejnë programeve të studimit: 2500. Numri i librave që i shërbejnë detyrave dhe projekteve: mbi 6500. Përsa i përket literaturës në formë elektronike në gjuhë të huaj janë bërë abonime në bibliotekën online. Gjithashtu ka shërbime në platforma dhe link-et për aksesimin e bibliotekave ndërkombëtare online. Biblioteka ka marrëveshje bashkëpunimi si me projekte dhe institucione të huaja të cilat i mundësojnë akseset në rrjetet e tyre të bibliotekave online ose abonime të ndryshme ashtu dhe me institucione vendase si Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë, shtypshkronja dhe organizata të tjera të fushës. Titujt, artikujt dhe revistat shkencore online janë jo vetëm të shumta në numër, por dhe shumë të përshtatshme dhe cilësore për këtë program studimi.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	FSHS ka krijuar kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit <i>Master Profesional në "Psikologji Ligjore"</i> . Kapacitetet e bibliotekës garantojnë mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga të gjithë studentët e programit të studimit. Biblioteka Universitare, instaloi falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. Katalogu ofron një version të avancuar në kërkimin e informacionit. (<i>Ev. Biblioteka online, UT. https://unitir.edu.al/biblioteka-online/</i>)
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e FSHS dhe ajo e Rektoratit, janë të pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Regjistrimet gjenden edhe pranë Bibliotekës Virtuale të Shqipërisë. https://plus.al.cobiss.net/opac7/bib/search?db=udu . Katalogu Botëror EorlCat http://ëëë.eorlcat.org/ Katalogu i Bibliotekës Britanike http://catalog.bl.uk/ Katalogu i Bibliotekës së Kongresit Amerikan http://catalog.loc.gov/ Index Translationum http://databases.unesco.org/xtrans/xtra-form.shtml

	Katalogu përmbledhës i bibliotekave të Francës – CCFr http://ccfr.bnf.fr/portailccfr/servlet/LoginServlet Për përdorimin e bibliotekës online në dispozicion të studentëve dhe të të interesuarve është dhe një manual, i cili mundëson shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Oraret e shërbimit të bibliotekës janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, kjo në përgjigje edhe të nevojave studimore të studentëve, numrit të tyre dhe kapacitetit të mjediseve të saj. Biblioteka qëndron e hapur çdo ditë nga ora 08.00 – 18.00 edhe në fundjavë. Sipas punonjësve të bibliotekës ky orar krijon kushte optimale për akses tek fondi i librave. Hapësira fizike dhe kapaciteti i saj i jepnin mundësi një numri të konsiderueshëm studentësh për shfrytëzim të ambjenteve në të njëjtën kohë, dhe duke pasur mundësi për shfrytëzimin e disa këndeve të saj që të lejonin të punojë në privatësi dhe pa u shpërqëndruar. Të gjithë të interesuarit mundet gjithashtu që të vihen në kontakt me punonjësit e bibliotekës dhe të kërkojnë shërbime dhe informacione edhe më të specializuara në info@fshs.edu.al. Biblioteka ka aktualisht 2870 anëtarë të rregjistruar të cilët kanë mundësi të shfrytëzojnë burimet e saj të materialeve. Për tu bërë anëtar i bibliotekës nevojiten këto dokumenta: Karte identiteti dhe libreze studenti. Pavarsisht abonimit në bibliotekë, të drejtën për të përdorur shërbimet e saj e kanë të gjithë studentët dhe stafi akademik, të cilët mund të shfletojnë literaturën fizike, të përdorin kompjuterat dhe të aksesojnë materialet online.
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë	Bazuar në dokumentacionin që na është vënë në dispozicion për programin e studimit master profesional “Psikologji Ligjore”, dhe në mënyrë të veçantë relacionit për aktivitetin e bibliotekës, GVJ konkludon se njësia përgjegjëse për programin dhe biblioteka periodikisht kanë hartuar kërkesat për përditësimin e fondit fizik., të cilat nuk janë përmbushur në masën e duhur nga institucioni. Përsa i përket fondit të librave online ai është rritur dhe përditësuar, kjo dhe falë bashkëpunimeve dhe projekteve ; kështu biblioteka dixhitale EBSCO host numëron akses në një mori platformash online me një fond të pakushtëzuar dhe të përditësuar. Gjithashtu edhe aksesit i pakushtëzuar në JSTORE garanton akses në më shumë se 1000 revista shkencore, mijra libra, qindra raporte në fushën e <i>Master Profesional në Psikologji Ligjore</i>. Nga takimi me personelin akademik na u konfirmua fakti se për marrjen e gradave dhe titujve akademik kanë pasur lehtësira dhe ndihmesë nga

përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	institucioni, jo vetëm me lehtësirat për shfrytëzimin e materialeve, por dhe me financimin e pjesëmarrjeve dhe e botimeve shkencore në këto revista me faktor impakti.			
Konkluzione	<i>Literatura bazë dhe ndihmëse e nevojshme dhe e përditësuar është në dispozicion të studentëve nëpërmjet bibliotekës si dhe nëpërmjet përdorimit të platformës Teams, ku pedagogu krijon klasën virtuale. Studentët kanë dy biblioteka, një në FSHS dhe tjetra në mjedeset e rektoratit të UT-së.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, në UT (Ev. 1-10 Rregullore të funksionimit të sistemit informatik në U; dhe shërbime online) përdoret sistemi E-student, i cili është një platformë elektronike nëpërmjet të cilës krijohen, ruhen, përditësohen dhe saktësohen të dhëna për studentët e regjistruar në këtë universitet nga faza e regjistrimit, ruajtja e vlerësimeve dhe diplomimi. Në këtë program departamentet ndihmëse (sekretaria, financa, etj) kanë akses të limituar sipas profilizimit të informacionit. Sektori IT është përgjegjës për procedurën e regjistrimit online të studentëve, i cili publikon afatet, rregullat dhe udhëzimet përkatëse se si do të zhvillohet procesi i regjistrimit; çdo student regjistrohet në këtë universitet nëpërmjet portalit E-Albania dhe vetëm pas regjistrimit sektori IT i pajis studentët e vitit të parë me fjalëkalimin dhe emrin e përdoruesit për të garantuar akses në regjistrat online (Ev. Manual i përdorimit të sistemit informatik..). Nëpërmjet këtij sistemi studentët mund të aksesojë në llogarinë personale të tij të dhënat akademike dhe të dhëna të tjera sensitive, siç janë ato financiare, po ashtu dhe stafi akademik ka akses vetëm në të dhënat akademike, duke ofruar mundësi përdorni të dhënash vetëm për përmbushjen e funksioneve. Sistemi është i konfiguruar me role të përcaktuara dhe

	informacioni ruhet në një bazë të dhënash të centralizuar. Sistemi ofron informacione të ndryshme për vijueshmërinë e vitit aktual akademik etj.
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	UT në përmbushje të misionit të tij ka aplikuar struktura teknologjike si dhe ka mundësuar aplikimin dhe përdorimin e sistemeve të integruara për menaxhimin. Kështu referuar statutit të universitetit dhe rregullores së tij, administrimi i informacionit menaxhohet sipas strukturave përgjegjëse të institucionit. Ky informacion ruhet në formën hardcopy dhe elektronike në disa njësi të universitetit, siç janë: Departamenti, Fakulteti, Universiteti, Zyra e Burimeve Njerëzore, Sekretaria mësimore, IT dhe një sër Zyrash të tjera të cilat secila sipas funksionit është e mandatuar të menaxhojë, monitorojë, krijoj apo auditoj aktivitete të ndryshme të personelit akademik, ndihmës akademik administrativ apo dhe të tjera veprimtari jashtë universiteti. I gjithë komunikimi në UT mundësohet përmes rrjetit të brendshëm të tij dhe sistemit E-student i cili garanton ndarjen në mënyrë të sigurt të informacioneve univeristare dhe burimet kompjuterike prej nga nisen këto informacione. Gjithashtu komunikimi ndërmjet stafit akademik dhe studentëve realizohet edhe nëpërmjet platformave të tjera si Teams apo Goolge Clasroom, duke shtuar si kanalet e komunikimit dhe duke lehtësuar aksesin në informacione.
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i ofruar nga UT siguron akses të dedikuar, gjithashtu institucioni zbaton me rigorozitet detyrimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale (Ev 1-10 Rregullore e menaxhimit të sistemit informatik në UT). Informacione mbi strukturën akademike, orarin mësimor, kurrikulën e programit, mundësitë e punësimit, kompetencat e stafit dhe të studentëve gjenden lehtësisht edhe në faqen ëeb të institucionit (Faqja zyrtare FSHS. https://fshs-ut.edu.al/), online në seksionet përkatëse të fakultetit dhe departamentit, facebook ose Instagram (https://ëeb.facebook.com/fshsut/?_rdc=1&_rdr#). Sistemi E-student siguron në nivel institucional, fakulteti dhe departamenti akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. Çdo përdorues ka kodin dhe fjalëkalimin e tij në sistemin e menaxhimit të të dhënave.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të	Bazuar në dokumentat e disponuar dhe takimet në institucion, GVJ konstaton se institucioni ka vënë në dispozicion për komunikimin e brendshëm interaktiv të stafit akademik dhe studentëve përveç platformës E-student dhe sisteme të tjera si Teams, Google

komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	classroom, të cilat sigurojnë akses në shumëllojshmëri dhe në numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në literaturën e lëndëve që ndjekin, regjistrimi i provimeve, vlerësimet nga pedagogu, vlerësimet përfundimtare të lëndës. GVJ nga takimet me stafin akademik dhe studentët, konfirmuan shkëmbimin në kohë reale të informacioneve dhe të njoftimeve që realizoheshin nëpërmjet sistemeve të menaxhimit dixhital.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi teknologjik i menaxhimit të informacionit, E-student, Teams etj, sigurojnë monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për ta, kjo për të gjithë përdoruesit e tij. Sistemi ofron mundësi për çdo lloj kërkesë që pedagogu mund të ketë për organizimin e procesit të mësimdhënies, si dhe u mundëson pedagogëve auditim të plotë të gjithë aktivitetit dhe përdorimit të sistemit nga studentët. Ky sistem shpesh përdoret edhe për lajmërimet të përgjithshme në rang fakulteti ose universiteti. Po ashtu institucioni ruan dhe komunikimin dhe koordinimin midis stafit akademik dhe studentëve si fizikisht ashtu dhe me anë të kontakteve telefonike dhe e-maileve zyrtare të tyre dhe rrjeteve sociale. GVJ gjatë vizitës në institucion dhe kryesisht gjatë takimit me studentë konfirmoi që të gjithë përdoruesit kanë akses në informacionet e tyre të personalizuar sipas roleve dhe njësive përkatëse. Stafi akademik dhe administrativ çlirohen nga detyrat e lodhshme manuale. Sistemi i menaxhimit u siguron atyre informacione të përditësuara dhe në kohë reale, pa burokraci.
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Është lehtësisht e përdorshme dhe e aksesueshme faqja zyrtare e UT-së (Shërbime online Universiteti i Tiranës https://unitir.edu.al/aksesi-online/) dhe FSHS (Faqja zyrtare FSHS. https://fshs-ut.edu.al/), ku paraqitet një informacion i plotë mbi filozofinë dhe misionin, partnerët, drejtimin dhe funksionimin, organikogramën; guidat për studentët e ardhshëm si dhe mbi programet, së bashku me bio të detajuara të personelit akademik etj. Përmes saj, por edhe rrjeteve sociale, institucioni promovon veprimtaritë e ndryshme me karakter akademik por edhe social-kulturor. Kjo faqe bën publikimin në dy gjuhë, shqip dhe anglisht (Faqja zyrtare UT. https://unitir.edu.al/en/). Programi i studimit Master Profesional “Psikologji Ligjore” gjithashtu ka të dhënat e veta të detajuara dhe në faqen zyrtare të FSHS Master në “Psikologji Ligjore” (https://fshs-ut.edu.al/programet-e-studimit-pedagogji-psikologji/master-profesional-psikologji-ligjore).

Konkluzione	<i>Institucioni disponon sistemin E-student, i cili është një platformë elektronike bashkëkohore nëpërmjet të cilës krijohen, ruhen, përditësohen dhe saktësohen të dhëna për studentët e regjistruar edhe në këtë program studimi, nga faza e regjistrimit, ruajtja e vlerësimeve dhe diplomimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në të dhënat e shqyrtuara nga GVJ, në materialet lidhur me raportin financiar të UT dhe FSHS informohemi se Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë, ka zëra të veçantë në planin e financimit të programit të studimit (Ev. 2.34. Dokumenta të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programit të studimit FSHS). GVJ evidenton se Departamenti ka hartuar pasqyra dhe raporte financiare të të ardhurave të cilat përfshihen dhe në plan buxhetin për mbarëvajtjen e programit, raportin financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Plani i financimit të FSHS ku bën pjesë dhe Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë përfshin në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe sigurimin e aksesit në bibliotekat on-line. Ai është pjesë e planit të njësisë kryesore. Departamenti ka hartuar planin e financimit. Ky plan financimi është hartuar duke mbajtur në konsideratë nevojat e zhvillimit të veprimtarive mësimore dhe shkencore edhe duke ndarë të ardhurat sipas burimeve të krijimit të tyre. Në këtë plan financiar përfshihen shpenzimet operative për blerje mallrash e shërbimesh dhe preventive për pajisje elektronike mbështetëse të procesit mësimor, dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	UT është një institucion publik i arsimit të lartë dhe si i tillë respekton kuadrin ligjor mbi menaxhimin financiar me relacionet përkatëse për projekt buxhetin afatmesëm dhe afatgjatë. Ai gjithashtu realizon dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit të të gjitha cikleve përgjatë kohës së shtrirjes së tyre, objektivave dhe investimeve të nevojshme për garantimin dhe rritjen e cilësisë. UT ka strukturat e veta për auditim si dhe ka miraturat procedurat përkatëse për këtë, si dhe kryen auditim të përvitshëm. Raporti vjetor i institucionit hartohet nga njësia e auditimit të brendshëm, dhe auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur e cila jep siguri objektive. Statusi organizativ, qëllimi misioni, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm përcaktohen në Kartën e Auditit

	të UT-së. Dokumentimi dhe gjendja e financimit gjenden dhe në faqen eeb të institucionit. (Auditi financiarë i UT). http://www.unitir.edu.al/images/Komunikimi/Programi_Vjetor_i_Auditimit_.pdf			
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionin, të ardhurat dhe financimet e ndryshme të UT-së dhe FSHS-së (Ev. 2.34. <i>Dokumenta të buxhetit, raporte financiare dhe kostoja e programit të studimit FSHS</i>), informohemi mbi të ardhurat nga pushteti vendor/qendror, nga grantet për kërkimin dhe kontratat; tarifat dhe përgjatë shkollimit; sponsorizimet; shërbimet trajnuese; dhe aktivitetet tregëtare, të cilat tregojnë që institucioni ka burime në dispozicion për financimin e programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	Në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ ka konkluduar se raportet financiare të institucionit janë të dokumentuara, dhe të specifikuara për të gjithë njësitë kryesore dhe bazë të aktivizuara. Hartimi i një raporti në lidhje me raportimet financiare të deritanishme dhe më specifikisht dhe me planifikimet financiare për periudhën pasardhëse dhe me transparencën financiare i jep mundësi institucionit të këtë një opinion ligjor të pavarur mbi pozicionin financiar, performancën dhe përputhjen me standardet e kërkuara të kontabilitetit dhe me qëndrueshmërinë financiare. Raporti financiar i cili përgatitet nga Rektorati dhe miratohet nga Bordi i Administrimit bazohet në planifikimet e kryera në programimin financiar. Sipas raportit të planit financiar të programit të studimit Master Profesional në "Psikologji Ligjore" dëshmohej një qëndrueshmëri financiare dhe kapacitete të mjaftueshme për sigurimin në vijimësi të veprimtarive akademike e institucionit dhe kapacitete publike të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve.			
Konkluzione	UT është një institucion publik i arsimit të lartë dhe si i tillë respekton kuadrin ligjor mbi menaxhimin financiar. Plani i financimit të FSHS ku bën pjesë dhe Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë përfshin në mënyrë të hollësishme të gjitha detyrimet financiare, pagat, shpenzimet, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës, si edhe sigurimin e aksesit në bibliotekat on-line.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në Statutin e UT, Rregulloren e tij (Ev. Statuti i UT; Ev. Rregullore e UT;) si dhe Rregulloren e programit të studimit (Ev. Rregullore e programit të studimit), përcaktohen politikat dhe procedurat për pranimin dhe transferimin e studentëve në këtë program studimi. Informimi i studentëve për kurrikulën, organizimin dhe të dhëna të tjera për programin e studimit fillon që në javët e para, nëpërmjet komunikimit me sekretarinë kur ata aplikojnë. Të dhënat e programit të studimit janë lehtësisht të aksesueshme edhe në faqen zyrtare të institucionit, sipas programeve dhe departamenteve përkatëse (Ev. Udhëzim për provimet). Informacioni për kriteret dhe kuotat e pranimin publikohet online (Ev. Kuotat e pranimin 2023-2024. https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2023/03/kuotat-e-pranimin-2023-2024-bachelor.pdf . Ev. Kriteret e pranimin, kuotat dhe tarifat e studimit. https://unitir.edu.al/kriteret-e-pranimin-kuotat-dhe-tarifet-e-studimit/), në broshurën informuese, (Ev. <i>Broshurë për maturantët</i>) përmes fletëpalosjeve dhe aktiviteteve të Departamentit.
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe	Procedurat që lidhen me pranimin e studentëve, vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme të këtij institucioni duke garantuar barazinë dhe të

studentët e programit të studimit.	drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit master profesional “Psikologji Ligjore”.
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kriteret dhe procedura e pranimi në këtë program të ciklit të dytë të studimit propozohen nga njësi bazë dhe pasi kanë marrë miratimin e dekanatit dhe senatit akademik, publikohen online në faqen zyrtare të UT/FSHS-së. Studentët pranojnë në këtë program studimi pasi kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve dhe kanë një diplomë të ciklit të parë në fushën e psikologjisë ose në fusha të përafërta. Në faqen zyrtare të institucionit janë të shpallura të gjitha informacionet që lidhen me procedurat e pranimi (Ev. Kriteret dhe kuotat e pranimi), dokumentacioni që kërkohet, kohëzgjatja e programit dhe numri i krediteve që fiton studenti.
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimi dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimi përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret dhe procedurat e pranimi të studentëve në këtë program studimi janë transparente dhe të publikuara edhe në faqen zyrtare. (Ev. Kuotat dhe kriteret e pranimi, https://unitir.edu.al/ep-content/uploads/2023/03/kuotat-e-pranimi-2023-2024_bachelor.pdf .) Në rregulloren e programit të studimit janë përcaktuar kriteret e pranimi të studentëve në programin e studimit MP në “Psikologji Ligjore”. Njëkohësisht informacionet që kanë të bëjnë me arritjet akademike të studentëve, vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë përcaktuar qartë në rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e UT dhe janë lehtësisht të aksesueshme.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Departamenti i pedagogjisë dhe psikologjisë informon të interesuarit në lidhje me kërkesat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në këtë program studimi përpara fillimit të çdo viti akademik (Ev. Programet e studimit, faqe zyrtare e UT). Nga njësi kryesore dhe departamenti organizohen ditët e informimit të cilat i adresohen të interesuarve, ish-studentëve dhe të diplomuarve të ciklit të parë të FSHS, por dhe studentëve të nga institucione të tjera brenda vendit dhe rajonit. (Ev. Open Day në Fakultetin e Shkencave Sociale, organizuar nga department I Psikologjisë dhe i Sociologjisë dhe Zyra e karrierës. https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1342 .)
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të	Në kuotat e miratuara, janë parashikuar edhe kuota për kategori të veçanta apo kuota nga trojet shqiptare. Konkretisht për programin Master Profesional në “Psikologji Ligjore” për vitin akademik 2023-2024 janë miratuar 30 kuota, ku 25 kuota janë për shtetas shqiptar brenda vendit, 1 kuotë për aplikantë për program

veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	të dytë studimi, 1 kuotë për aplikantë që aplikojnë për transferimet e studimeve, 1 kuotë për minoritetin Romë dhe Egjiptian, 1 kuotë për studentët me statusin e jetimit dhe 1 kuotë për aplikantët nga trojet shqipfolëse. <i>(Ev. Njoftim për aplikantët nga trojet, me statusin e personit me aftësi të kufizuar, me statusin jetim, pakicave romë dhe egjiptiane. https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1669.)</i>			
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kuotat dhe kriteret e pranimit, pas propozimit të njësisë bazë dhe miratimit nga Senati Akademik i UT, publikohen edhe në faqen zyrtare duke i mundur aksesin kujtdo që është i interesuar në çdo kohë. Për vitin akademik 2023-2024 në këtë program ka një kuotë të parashikuar dhe siç referohet edhe nga institucioni ka interes edhe nga studentë të ardhur nga shtete të tjera shqipfolëse si Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Medvegja dhe Bujanovci.			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Në faqen zyrtare të FSHS janë të publikuara informacione dhe gjenden njoftime për përfitimin e bursës ose përjashtimin nga tarifat e shkollimit si student të shkëlqyer, apo për shtresa në nevojë si; persona me aftësi të kufizuar, student që kanë të dy prindërit me aftësi të kufizuar, etj. <i>(Ev. Për përfitimin e bursës ose përjashtimin nga tarifat e shkollimit. Viti akademik 2023-2024. https://drive.google.com/file/d/1crChz-Z2-xhj3eeeAëdrvZrf1B8950tJ/vieë)</i>			
Konkluzione	<i>Procedurat që lidhen me pranimin dhe vazhdimin e studimeve deri në diplomim janë në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, udhëzimet e MASR si dhe statutin dhe rregulloren e brendshme të këtij institucioni duke garantuar barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit master profesional "Psikologji Ligjore".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Në rregulloren e Departamentit dhe të programit të studimit parashikohet kriteret dhe procedura e pranimit të studentëve në këtë program studimi, njohja e krediteve edhe nga programe të tjera dhe kohëzgjatja normale e studimeve, e cila nuk mund të jetë më shumë se dyfishi i kohëzgjatjes normale të studimeve. Informacioni është në dispozicion të studentëve dhe të të interesuarve edhe në faqen zyrtare të FSHS. GVJ konfirmion se studentët kishin informacionin mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve. <i>(Ev. Rregullore e UT, Rregullore e FSHS dhe Rregullore e Programit të studimit).</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Për të gjithë studentët e rinj të regjistruar realizohet procesi i pritjes dhe orientimit të kandidatëve. Gjatë javës së parë në hollin e institucionit vendosen vende pritje ku realizohen takime për shpjegimin e sistemit të studimeve, rregulloreve dhe procedurave administrative të institucionit. Në rregulloret e UT/FSHS dhe të programit të studimit gjenden dhe procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, për efekt të njohjes dhe ekujalentimit të tyre me lëndët e njëjta ose të ngjashme të programit të studimit.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në rregulloret e institucionit dhe specifikisht në rregulloren e programit të studimit <i>(Ev.3-6. Rregullore e programit të studimit)</i>, si dhe në syllabusin e çdo lënde gjenden mënyra e vlerësimit të studentit dhe pesha specifike e rubrikave të vlerësimit të vazhdueshëm në vlerësimin përfundimtar. Studentët njihen me mënyrën e vlerësimit të çdo lëndë në javën e parë. <i>GVJ në takimin me studentët konfirmoi që gjatë javës orientuese studentët e vitit të parë informohen në detaje rreth programit të studimit.</i> <i>(Ev. Program i transparencës së UT, https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-ut/).</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në Rregulloren e Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë dhe në atë të programit të studimit (neni 21) parashikohen procedurat dhe kriteret për diplomimin e studentëve. Nga Departamenti është miratuar paketa dhe rregullorja e diplomimit, ku specifikohen edhe modalitetet që nga përzgjedhja e temës sipas interesave të vet studentëve, miratimi i udhëheqësit dhe vlersimi i diplomës.

	<i>(Ev. 4-5. Paketa e diplomimit dhe Rregullore për diplomimin.)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	FSHS për tërheqjen e studentëve të rinj çdo fillim vitit akademik organizon grupe pune, të cilët informojnë studentët me programet e studimit që ofron, kushtet dhe shërbimet për studentët, për t'i ndihmuar ata në vendimarrje. Këtë e realizon nëpërmjet njoftimeve në faqen zyrtare të institucionit apo në rrjetet sociale si facebook dhe instagram, stendat e Universitetit dhe guidës së studentit. Për këtë qëllim nga institucioni ka hartuar dhe broshura informuese në hardcopy dhe në formë elektronike.			
Konkluzione	<i>Procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve janë të përcaktuara në të gjithë rregulloret e UT/FSHS-së, dhe specifikisht gjenden edhe në rregulloren e programit të studimit, si dhe në syllabusin e çdo lënde. Arritjet akademike janë të disponueshme për studentët nëpërmjet sistemit E-student Transparenca e marrëdhënieve mes stafit dhe studentëve rregullohet dhe me një urdhër të Rektorit të UT-së</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, planin mësimor, lëndët, tarifat e studimit, gjenden në faqen zyrtare të universitetit <i>(Ev. Programet e studimit të UT. https://unitir.edu.al/programe-studimi/ dhe Open Day në Fakultetin e Shkencave Sociale, organizuar nga department I Psikologjisë dhe i Sociologjisë dhe Zyra e karrierës. https://fshs-ut.edu.al/njoftim?id=1342).</i> Studentët që pranohen në programin e studimit informohen gjatë javës së parë mbi të drejtat dhe detyrat universitare, kohëzgjatjen maksimale të periudhës së studimeve; ndërsa informacioni mbi programin e studimit janë të publikuara dhe përditësuara në faqen zyrtare të institucionit.

Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Studentët marrin çdo informacion të nevojshëm në lidhje me kurrikulën e programin të studimit (lëndët), rregjistrimet, orarin dhe provimet, regjistrimi për provime dhe vlerësimet e notat përkatëse gjatë ditëve të orientimit, takimeve informuese me stafin dhe pedagogët, si dhe nëpërmjet faqes zyrtare gjatë fazës së regjistrimit. Informacion i detajuar për çdo lëndë ju jepet nga pedagogu i lëndës në javën e parë, gjatë prezantimit të syllabusit ku jepen informacione specifike për temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar.
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Studentët informohen për mundësinë e punësimit dhe për informimin drejt dhe në tregun e punës nëpërmjet Zyrës së Kominikimit, Alumnit dhe Karrierës, por dhe në panairin e punës. Zyra e Kominikimit, Alumnit dhe Karrierës ka hartuar edhe Udhëzuesin e Karrierës, i cili iu vjen në ndihmë studentëve dhe alumnit në procesin e intershipit, kërkimit dhe aplikimit për punë. <i>(Ev. Udhëzues i Karrierës)</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	UT ka vënë në dispozicion të studentëve një nga sistemet IT më të mira përsa i përket të gjithë procesit të menaxhimit universitar, sistemi E-student, platforma GRADUA, <i>(Ev. Platforma Gradua. https://ëëë.graduaproject.com/ëp-content/uploads/2020/04/GRADUA-Manual-Studentet-SHQIP.pdf)</i> i cili i siguron akses në një numër informacioni si regjistrimi i studentëve në lëndët përkatëse, akses i plotë në informacionin, detyrimet dhe literaturën e lëndëve që ndjekin <i>(Ev. 1-10. Rregullore e funksionimit të sistemit informatik në UT)</i>. Secili pedagog është regjistruar në sistem në lëndët e veta dhe kështu mund të menaxhojë krejt lehtësisht gjithë procesin akademik. Akses i këtyre platformave bëhet nëpërmjet kredencialeve të cilat ju jepen studentëve sapo fitojnë status student nga Zyra IT.
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Përmes platformës së menaxhimit të sistemit mësimor që përdoret për çështjet administrative e akademike të studentëve, mundësohet informacioni në lidhje me programin e studimit si regjistrimi, lëndët, syllabuset e lëndëve, materialet e studimit, oraret mësimore, provimet, pagesat studentore, komunikime e njoftime të ndryshme etj. Akses i internetit por edhe në platformat e menaxhimit është i garantuar nga interneti në mjediset e

	universitetit dhe nga aksesit pa limit në kompjuterat e vënë në dispozicion të studentëve në bibliotekë.			
Konkluzione	<i>Informimi i studentëve mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve, planin mësimor, lëndët, tarifat e studimit, gjenden në faqen zyrtare të institucionit. FSHS në dispozicion të nevojave profesionale të studentëve, ka vënë një sër zyrash që bashkërendojnë punën me njëra tjetrën si, Zyrën e Kominikimit, Alumnit dhe Karrierës, por dhe panairin e punës dhe informimin për mundësi punësimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve												
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në programin e studimit. Përgjegjësi kryesore e mbajtjes së të dhënave të studentëve nga regjistrimi, deri në diplomim është e sekretarisë mësimore. Gjatë takimeve në institucion u konstatua se sekretaria mësimore administronte, rregjistrin themeltar të studentëve të rregjistruar dhe të transferuar si dhe rregjistrin e arritjeve akademike dhe të diplomuarve. Nuk vërejtë rubrika të paplotësuara apo parregullësi në administrimin e tyre. Në bazë të këtyre statistikave GVJ konstaton që për këtë program studimi kemi [Tabela 21: Tabelat Përmbledhëse]: Tabela 1: Numri i të regjistruarve / transferuarve dhe mesatarja përkatëse <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Studentë të regjistruar në vit të parë</th><th>Nota mesatare në hyrje</th><th>Studentë të transferuar</th></tr><tr><td>2022-2023</td><td>19</td><td>9.1</td><td>-</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>18</td><td>9</td><td>-</td></tr></table> GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në sekretarinë mësimore konfirmoi saktësinë e të dhënave të deklaruara.	Viti akademik	Studentë të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar	2022-2023	19	9.1	-	2023-2024	18	9	-
Viti akademik	Studentë të regjistruar në vit të parë	Nota mesatare në hyrje	Studentë të transferuar										
2022-2023	19	9.1	-										
2023-2024	18	9	-										

Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni disponon statistika për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në Master Profesional në “Psikologji Ligjore” në respektim të kuadrit ligjor e rregullativ. GVJ gjatë vizitës në sekretarinë mësimore konstatoi se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi për dy vitet e fundit akademike ishte për vitin akademik 2022-2023 – 19 studentë, nota mesatare - 9,1 dhe për vitin akademik 2023-2024 -18 studentë, nota mesatare - 9, nga të cilët nuk është rregjistruar asnjë studentë. Këto të dhëna janë në formë të shkruar dhe ruhen në Sekretarinë e Fakultetit në mënyrë konfidenciale.
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Zyra që merret me regjistrimin e studentëve, sekretaria mësimore janë strukturat e posaçme që merren me ruajtjen dhe menaxhimin e të dhënave statistikore nga hyrja deri në dalje. Punën e tyre e kryejnë edhe përmes platformës GRADUA (Ev. Platforma Gradua. https://www.graduaproject.com/wp-content/uploads/2020/04/GRADUA-Manual-StudentetSHQIP.pdf) apo E-student edhe përmes sistemit informatik të rregjistrave dhe arkivave të të dhënave të plota. Këto të dhëna disponohen për të gjithë studentët e universitetit dhe janë të sigurta, pasi sistemi është pjesë e RASH, i cili garanton sigurinë, si dhe në të kanë akses vetëm personat e autorizuar. Studenti ka dosjen personale, e cila ka të gjitha të dhënat që janë marrë në fazën e regjistrimit dhe vazhdojnë të përditësohen në vijim përgjatë viteve të studimit.
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	UT ka hartuar një sërë dokumentesh që favorizojnë kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin e sekretarive mësimore si dhe sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit si dhe vlerëson e dokumenton gjendjen dhe saktësinë e dokumentacionit që lidhet me studentët dhe me veprimtaritë e tyre (Ev. Rregulloret UT, FSHS, Programit të studimit dhe Ev. 2-14-Rregullore e sigurimit të cilësisë në FSHS). Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve arkivoheshin dhe ishin lehtësisht të verifikueshme nga persona të autorizuar. GVJ verifikoi të dhënat e studentëve të rregjistruar e të diplomuar, si dhe të ecurisë akademike në mënyrë rastësore dhe nuk konstatoi mangësi.
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike,	Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë harton raporte analitike dhe periodike vjetore ku ndër të tjera trajton edhe cilësinë

periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe punësimit të tyre duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve (Ev. 3-13 Raporti për veprimtaritë e programit). Gjithashtu edhe mënyra se si informohen studentët e interesuar kryesisht për punësimin është në vëmendje të institucionit. Vëmendje e shtuar tregohet në nivel institucional lidhur me masat në drejtim të përmirësimit të treguesve të cilësisë në hyrje, dalje dhe të punësimit të studentëve.			
Konkluzione	<i>Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuar në programin e studimit. Përgjegjësin kryesore e mbajtjes së të dhënave të studentëve nga regjistrimi, deri në diplomim është e sekretarisë mësimore. Gjatë takimeve në institucion u konstatua se sekretaria mësimore administron, rregjistron themeltar të studentëve të rregjistruar dhe të transferuar si dhe rregjistrin e arritjeve akademike dhe të diplomuarve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Studentët përfaqësohen në organet vendimmarrëse si Senatin Akademik, Komisionin për Garantimin e Standarteve dhe Cilësisë, Këshillin e Etikës, si dhe në këshillin studentor. Përfshirja e tyre në këto struktura garantohen nga Statuti i UT, Rregullorja e Institucionit, Rregullorja e FShS, Rregullorja e Departamentit dhe e Programit të Studimit. (Ev. 2.26 Politika për mbështetjen e studentëve; Ev. Rregullore të UT; Ev. 2.4. Rregullore e FSHS; Ev.3.3. Rregullore Departamentit dhe Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo	Studentët janë pjesë aktive e mbledhjeve të senatit akademik. Ata si pjesë e grupeve të vlerësimit të brendshëm të cilësisë janë në brendësi të mbarëvajtjes së punës mbi vlerësimin e procesit akademik. Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut përmes

vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	pyetësorëve. Angazhimi i studentëve në vlerësimin e programit të studimit është reale dhe frutdhënëse. (Ev. 2.26 Politika për mbështetjen e studentëve).			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Përfshirja e studentëve në procesin e vlerësimit të programit të studimit garantohej nga Departamenti i pedagogjisë dhe psikologjisë, si njësia përgjegjëse e këtij programi studimi. Departamenti realizonte takime dhe fokus grupe me studentët për të nxitur përfshirjen e tyre në proceset akademike ekstrakurrikulare. Një tjetër aspekt që lidhet me përfshirjen e tyre janë dhe ftesat për takime për aktivitetet të ndryshme të organizuara nga njësia bazë, mbledhjet e përbashkëta dhe plotësimi i pyetësorëve, të cilët përmbajnë dhe rubrika për planin mësimor të programit të studimit.			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Rregulloret e brendshme të institucionit (Ev.3.3. Rregullore Departamentit) por dhe ajo e programit të studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore” (Ev. 3.6. Rregullore e programit të studimit) si dhe ato të UT-së ju mundësojnë studentëve një proces transparent mbi mënyrën e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve duke shtuar përdorimin e teknologjisë edhe në vlerësimin dhe kontrollin e dijeve. Në drejtim të ndershmërisë së kryerjes së procesit janë sekretimi i provimeve, argumentimi i vlerësimit nga pedagogu, zhvillimi i seancave sqaruese dhe mundësia e kërkesës për rivlerësim nga një komision i posaçëm. Studentët kanë mundësi të parashetrojnë kërkesat e tyre duke plotësuar formularët përkatës pranë sekretarisë apo njësisë bazë.			
Konkluzione	Institucion parashikon dhe garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse si Senatin Akademik, komisionin për garantimin e standarteve dhe cilësisë, këshillin e etikës, si dhe në këshillin e studentëve. Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogut, dhe në vlerësimin e programit të studimit në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

63

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në FSHS ka njësi të posaçme në shërbim të informimit e mbështetjes ndaj studentëve, siç është Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë, Zyra e çështjeve studentore dhe ajo Alumni, Biblioteka, apo dhe Kordinatorët e programeve të studimit. Këto struktura ofrojnë një sër shërbimesh për studentët përgjatë të gjitha fazave të studimit në këtë program studimi dhe vijnë edhe pas përfundimit të studimeve përmes shërbimeve që këto zyra ofrojnë për alumnit e saj.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Kordinatori i programit të studimit, stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimi, zyra e këshillimit të karrierës nën drejtimin e Departamentit të Pedagogjisë dhe Psikologjisë ofrojnë informim, këshillim si dhe ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimi i tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Këto zyra mbulojnë shërbimet që ju nevojiten studentëve për një ecure të sukseshme në këtë program studimi.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Punonjësit sektorit të karrierës dhe alumnit mirëpresin studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me procesin mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. Zyra organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, takime periodike për të marrë mendime, ndarë eksperiencë në lidhje me përmirësimet e mundshme. Këto aktivitete orientojnë studentët për përzgjedhjen e institucioneve të zhvillimit të praktikës profesionale. Gjithashtu platforma GRDAUA u lejon studentëve të kenë lehtësi kontakti me tregun e punës u mundëson studentëve të krijojnë CV-në e tyre personale, të kenë qasje të lehtë në informacion mbi mundësitë e punës / praktikës profesionale, të përgjigjen në oferta pune direkt përmes platformës, të kontaktohen nga kompanitë. (Ev. Platforma Gradua. https://www.graduaproject.com/epcontent/uploads/2020/04/GRADUA-Manual-Studentet-SHQIP.pdf)

Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Komunikimit, Alumni dhe Karrierës ka si objektiv të punës së saj mbështetjen e studentëve përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit. Ajo luan një rol të rëndësishëm në orientimin e studentit drejt mundësive të punësimit, por edhe në drejtim të ofrimit të këshillimit për karrierën me qëllim vlersimin më objektiv të mundësive që student ka në dispozicion. Kjo zyrë vendos kontakte me Alumnit e UT-së me qëllim gjurmimin dhe mbledhjen e informacioneve mbi punësimin e tyre e duke evidentuar rastet e suksesit si dhe duke i ardhur në ndihmë atyre që janë të papunë për t'i informuar mbi mundësi punësimi dhe praktikash si dhe Ftesën për Alumnit e suksesshëm për të zhvilluar orë të hapura leksioni apo seminaresh për studentët ku të tregojnë mbi eksperiencat e tyre profesionale dhe karrierën e tyre të suksesshme.			
Konkluzione	FSHS ka njësi të posaçme në shërbim të informimit e mbështetjes ndaj studentëve, siç janë Njësia Bazë, Zyra e çështjeve studentore dhe ajo Alumni, Biblioteka, apo dhe Kordinatorët e programeve të studimit, të cilët mbështetin studentët përgjatë gjithë rrugëtimit të tyre akademik dhe më tej përgjatë viteve të punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMI

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të	Institucioni ka miratur Komisionin e Përhershëm të Garantimit të Standarteve dhe Cilësisë (Ev. Komisioni i përhershëm për sigurimin e standarteve të cilësisë. https://unitir.edu.al/komisioni-i-perhershem-per-sigurimin-e-standardave-te-cilesise/), i cili është

ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	një komision i përhershëm që drejton politikat e institucionit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, ku janë përfshirë ekspertë të fushave të ndryshme dhe tre studentë. Në nivel Institucional strukturat përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë janë: - Senati Akademik - Komisioni i Përhershëm për Garantimin e Standardeve dhe Cilësisë (KPGSC) -Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DKSC)/Koordinatori Institucional pranë ASCAL (KIAL) - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standardeve të Cilësisë (DKSC). Në nivel Fakulteti përgjegjës për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë: - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pranë Fakultetit (NjBSC Fakulteti) - Koordinatorët e Programeve të studimit. <i>(Ev. Rregullore “Për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, në Univesitetin e Tiranës”.</i> https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranës/
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. Ky komision ndjek përmirësimin e cilësisë në UT, duke shërbyer si një garanci e shtuar. Në rolin e një komisioni të përhershëm, kërkon në mënyrë të vazhdueshme informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe programeve të studimit nga NjSBC. Kjo e fundit, ka si funksion kryesor bashkëpunimin dhe asistimin e këtij Komisioni. KPGSC mbikqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. <i>(Ev. Politika e sigurimit të cilësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale.</i> https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise/).
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Përfshirja e studentëve realizohet në mënyrë të strukturuar, si vlerësimi i pedagogut nga studenti, trajtimi i ankesave të studentëve si dhe vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ <i>(Ev. Rregullore mbi vlerësimin e performancës në punë të personelit ndihmës akademik dhe administrative.</i> https://unitir.edu.al/rregullore-mbi-vleresimin-e-performances-ne-pune-te-personelit-ndihmes-akademik-dhe-administrativ-ne-ut/). Rezultatet e këtyre

	sondazheve iu vihen në dispozicion drejtuesit të njësive kryesore dhe përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen. Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdoren edhe metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ.			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit. (Ev. Politika e sigurimit të cilësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale. https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise . Ev. Programi i transparencës në UT. https://unitir.edu.al/programi-i-transparences-2/ .)			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes rregullores të saj të veprimit synon kryesisht vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie, të shërbimeve, të programeve të studimit, vlerësimin e cilësisë së studentëve dhe të personelit. Departamenti plotëson raportin e vlerësimit të programit. Në këtë raport paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësime në të ardhmen, feedbacku i marrë nga studentët, nga personeli akademik i përfshirë në programin e studimit, të dhëna mbi ecurinë e studentëve etj.			
Konkluzione	Në nivel Institucional janë disa struktura përgjegjëse për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë. Nga NjSBC në mënyrë të vazhdueshme hartohen informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe programeve të studimit, në përputhje me procedurat e parashikuara në Manualin e Cilësisë të UT-së.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika,	Institucioni ka miratuar planin e zhvillimit strategjik për zhvillimin sa më të strukturuar e transparent të tij (Ev. Programi i

struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	transparencës së UT). Institucioni ka ndërtuar dhe Njësine Bazë të Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë në FSHS (Ev. Politika e sigurimit të cilësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale. https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise). Kjo strukturë e realizon punën e saj duke u mbështetur në një dokument të rëndësishëm për funksionimin e saj siç është Rregullorja për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë dhe ka mbështetjen e të gjithë stafit akademik dhe administrative.
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Plani strategjik i UT-së (Ev. Strategjia e zhvillimit të UT 2023-2028) evidenton se institucioni është i përkushtuar për të siguruar cilësi. UT ka ndërtuar strukturat përbërëse të Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe përgjegjësitë e secilit prej tyre, si në nivel institucional ashtu dhe në atë të njësisë kryesore. Cilësia në FSHS garantohet nga këto struktura (Ev. Politika e sigurimit të cilësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale. https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise): Komisioni i sigurimit të cilësisë, i cili ka përgjegjësinë për të garantuar se veprimtaria e FSHS-së i plotëson standardet shtetërore të cilësisë. Grupi i vlerësimit të brendshëm i FSHS është një organizëm ad hoc që aktivizohet sa herë ndërmerren veprimtari vlerësimi.
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit MP “Psikologji Ligjore”, Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë ka ngritur grupin e punës, i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm për këtë program studimi. Bazuar në informacionin në institucion, konstatohet se institucioni i ka kushtuar një rëndësi të veçantë rekrutimit të stafit akademik me tituj dhe grada shkencore dhe është duke i mbështetur ata me financime për avancimin në arritje akademike. Për sigurimin e cilësisë institucioni përdor instrumentet e ndryshme si pyetësorë me studentët, me stafin akademik, takimet në grup për të garantuar ndërhyrjen dhe përmirësimin e cilësisë nëse është e nevojshme.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale.	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, konstatohet se në strategjinë e zhvillimit institucional ka politika që synojnë përmirësimin e cilësisë për programin e studimit. Departamenti plotëson raportin e vlerësimit të programit, ku paraqiten të dhëna për programin e studimit, ndryshimet e mundshme të realizuara, planet për ndryshimet dhe përmirësimet. Struktura e sigurimit të brendshëm të cilësisë synon që për këto

Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	qëllime të realizojë monitorim të vazhdueshëm të punës së stafit akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët.			
Konkluzione	<i>UT ka ndërtuar strukturat përbërëse të Sistemit të Brëndshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe përgjegjësitë e secilit prej tyre, si në nivel institucional ashtu dhe në atë të njësisë kryesore, të cilat synojnë të realizojë monitorim të vazhdueshëm të punës së stafit akademik dhe administrativ me fokus sigurimin e cilësisë në menaxhim, zhvillimin e projekteve kërkimore, ndërkombëtarizimin përmes programeve të mobilitetit për stafin dhe studentët dhe përmirësimin e cilësisë për programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura	NjBSC në nivel Fakulteti (Ev. Politika e sigurimit të cilësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale. https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise), realizon në mënyrë autonome objektivat dhe masat e vendosura nga NjBSC në nivel institucional. Dokumentacioni i NjBSC në nivel Fakulteti i përcillet Dekanit dhe NjBSC në nivel Institucional. Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, rezulton një angazhim serioz i departamentit dhe stafit akademik përmes aktiviteteve mbikqyrëse në lidhje me vlersimin e përputhshmërisë së syllabuseve me standardet e institucionit për lëndët që zhvilloheshin në programet e studimit MP “Psikologji Ligjore”. Planit strategjik i institucionit bazohet në investimin në cilësinë e mësimdhënies, me qëllim që procesi i transferimit të dijeve të jetë gjithnjë e më i harmonizuar me njohuritë më të përparuara kombëtare dhe ndërkombëtare; në favorizimin e metodologjive të reja dhe mësimdhënia inovative, që e pozicionojnë studentin në qendër të procesit duke inkurajuar të menduarin kritik, përgatitjen për tregun e punës dhe promovimin e

autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	dialogut student-pedagog; si dhe në krijimn e një modeli të përmirësuar të garantimit të cilësisë së mësimdhënies.
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë përmes Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë pas realizimit të procesit monitorues, i propozon Senatit akademik për miratim instrumentat e cilësisë, format e publikimit të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe i propozon për miratim Senatit Akademik raportin e brendshëm të cilësisë së institucionit. Kjo nënkupton që departamentet mund të argumentojë dhe qartësojnë disa aspekte që lidhen me konstatimet e këtij komisioni. GVJ nga vizita në institucion konstaton se institucioni dokumenton në formë shkresore rezultatet dhe raportet e vlerësimeve, të cilat përfshijnë të dhëna përshkruese dhe sasiore mbi çështje që lidhen me gjendjen e programeve të studimit, vlefshmërinë e akreditimit, stafin akademik të rekrutuar, literaturën e re të hyrë në bibliotekë, rezultatet e arritura të studentëve, kalueshmëria dhe nota mesatare, marrëveshjet e bashkëpunimit, veprimtaria kërkimore shkencore.
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Nga informacioni i paraqitur nga institucioni, rezulton se institucioni për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda e instrumente të ndryshme të tilla si: pyetëtori i studentëve, mentorimet e studentëve, takimet në grup që zhvillohen nga drejtuesi i njësisë bazë. Instrumentat janë të hartuara në mënyrë të tillë që masin dhe vlerësojnë të gjithë komponentët e programit të studimit. Për të realizuar vlerësimin e programit Master Profesional në “Psikologji Ligjore” përdoren disa metoda të drejtpërdrejta si vlerësimi i cilësisë së programit e provimeve, vëzhgimet në auditor nga titullarët e njësisë bazë dhe njësisë kryesore, rishikimi periodik i programit, vlerësimi i arritjeve në mësimdhënie, vlerësimi i arritjeve të studentëve, nëpërmjet nxjerrjes së statistikave të kalueshmërisë së studentëve, notës mesatare, rishikimit të vazhdueshëm të programeve mësimore për secilën lëndë si dhe rishikimit të kurrikulave në përputhje me aktet ligjore në fuqi, kërkesat e tregut të punës apo edhe kërkesave të personelit akademik apo studentëve.
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të	Në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit Master Profesional në “Psikologji Ligjore”,

realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	institucioni realizon çdo semestër një sërë veprimtarish si vlerësimi i pedagogut nga studenti, ankesat e studentëve si dhe vetëvlerësimi i performancës së personelit akademik. Këto sondazhe i vihen në dispozicion përgjegjësit të departamentit me qëllim reflektimin për të ardhmen. Nga informacioni i paraqitur dhe atë marrë në në institucion, GVJ konstaton se institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor edhe metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program me qëllim përmirësimin e cilësisë.			
Konkluzione	GVJ evidenton se KSBC, monitoron punën e departamentit dhe stafit akademik përmes aktiviteteve mbikqyrëse në lidhje me vlerësimin e përputhshmërisë së syllabuseve me standardet e institucionit për lëndët që zhvilloheshin në programet e studimit MP "Psikologji Ligjore". Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përmes KSBC pas realizimit të procesit monitorues, i propozon Senatit akademik për miratim instrumentat e cilësisë, format e publikimit të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit, si dhe i propozon për miratim Senatit Akademik raportin e brendshëm të cilësisë së institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe	Nga informacioni i marrë rezulton se institucioni angazhohet të garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë, duke caktuar koordinatore të programit të studimit.

procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	(Ev.133, përcaktimi i koordinatorëve të programeve të studimit të ofroara nga Departamenti i Psikologjisë dhe Pedagogjisë). Institucioni bashkëpunon edhe me ekspertë të jashtëm duke ruajtur dhe mbajtur në konsideratë përmirësimin e vazhdueshëm të parametrave të cilësisë. Departamenti ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata me të cilët konsultohet lidhur edhe me rritjen e standarteve të cilësisë në mësimdhënie në këtë program studimi.
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Njësia përgjegjësi për garantimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, në nivel fakulteti, është Komisioni i Sigurimit të Cilësisë (Ev. Politika e sigurimit të cilësisë në Fakultetin e Shkencave Sociale, https://fshs-ut.edu.al/rreth-fakultetit/sigurimi-i-cilesise/); Komisioni i sigurimit të cilësisë është një organ kolegjal i përhershëm që ka përgjegjësinë për të garantuar se veprimtaria e FSHS-së i plotëson standardet shtetërore të cilësisë. Përgjigjet përpara dekanatit për politikën e vlerësimit dhe zbatimin e procedurave të menaxhimit të cilësisë dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe e këshillon dekanatin për çështjet e cilësisë.
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Njësia bazë, Departamenti i Pedagogjisë dhe Psikologjisë është përgjegjëse për mbarrëvajtjen e programit të studimit Master Profesional në "Psikologji Ligjore. Në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm, janë të përfshirë anëtarë të personelit akademik të departamentit dhe studentë të këtij programi studimi, të cilët kryejnë vlerësimin e brendshëm sipas procedurave të parashikuara.
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Personeli akademik i cili është angazhuar në procesin e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit nuk ushtron detyra në pozicione drejtuese në institucion dhe janë figura me integritet në njësinë bazë. Gjithashtu edhe përfshirja e studentëve në këtë proces është në funksion të respektimit të integritetit dhe barazisë ndaj personelit dhe studentëve.
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe	Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë për programin e studimit Master Profesional në "Psikologji

sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Ligjore” janë punonjës të UT-së. Në përbërjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm janë vetëm anëtarë të brendshëm të departamentit. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm apo bashkëpunëtorëve të ndryshëm, me të cilët departamenti bashkëpunon është realizuar për procese të veçanta, siç është praktika, apo bashkëpunimet me universitete dhe kolegë të bashkëpunimeve të huaja, duke i krijuar një mundësi të mirë.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se institucioni angazhohet të garantojë politika dhe procedura që sigurojnë rritjen e brendshme të cilësisë, kjo duke përfshirë edhe aktorë të brendshëm, në veçanti Departamentin e Psikologjisë dhe Pedagogjisë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat e institucionit dhe të gjithë aktivitetet e ndërmara në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe të bazuara në Kodin e Cilësisë. Gjetjet e vlerësimit të brendshëm dhe raporti janë transparente dhe bëhen publike duke u ndarë me studentët dhe stafin akademik, si dhe hedhur në faqen zyrtare të FSHS-së.
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni ruan dhe respekton legjislacionin për të dhënat personale, të dhënat e privatësisë, lirinë dhe etikën akademike – profesionale (Ev. Komisionet e përhershme dhe këshilli i etikës. https://unitir.edu.al/komisionet-e-perhershme/). Rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit janë transparente dhe bëhen publike. Të dhënat personale të stafit akademik japin informacion mbi kualifikimin e titujt e gradat që mbajnë.

Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë ka një analizë mbi pikat e forta dhe afirmimet dhe pikat e dobëta. Në raport shihet një tendencë për t'u fokusuar më shumë në evidentimet e pikave të forta dhe afirmimet më tepër, se sa në drejtim të pikave të dobëta. <i>Ref. Rvb</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Raporti i vlerësimit të brendshëm të cilësisë pas përfundimit përdoret nga vet institucioni për përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. Ndërmerren reagime dhe masat e duhura nga ana e njësisë bazë në lidhje me pikat e dobëta të evidentuara në këto raporte. <i>Ref. Rvb</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin akademik dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre në lidhje me sigurimin dhe përmirësimin e brendshëm të cilësisë. Strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë monitorojnë dhe dokumentojnë gjetjet e tyre, të cilët i ndajnë me strukturat e tjera me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.			
Konkluzione	<i>Të gjithë aktivitetet e ndërmara në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për këtë program Studimi janë transparente, duke ruajtur dhe respektuar legjislacionin për privatësinë dhe parimet për lirinë dhe etikën akademike –profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në
“Psikologji Ligjore” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i Tiranës**

Pikat e forta dhe afirmime

- 1) *Personel akademik i kualifikuar me tituj dhe grada shkencore, si dhe me përvojë dhe kontribute në zhvillimin e shkencës së psikologjisë*
- 2) *Përfshirja e personelit akademik dhe studentëve në projekte të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare.*
- 3) *Bashkëpunim i gjerë në realizimin e praktikave profesionale, duke krijuar mundësi për zhvillimin e aftësive praktike të studentëve.*
- 4) *Aksesi në burime elektronike bashkëkohore duke garantuar arritjet e një arsimi cilësor.*
- 5) *Kurrikula tepër cilësore e krahasueshme me programet më të mira Europiane*

Pika të dobta

1. Numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi ka qenë në rënie nga një vit akademik në tjetrin.
2. Mobiliteti i studentëve të këtij programi në nivel ndërkombëtar, pra në Institucione partnere jashtë vendit është mjaft i kufizuar.

Rekomandime

1. *Nxitja e interesit për këtë program Studimi, duke u bazuar jo vetëm në kurrikulën bashkëkohore të programit, por dhe duke bashkëpunuar me Institucionet përkatëse për të mundësuar se diploma MP në “Psikologji Ligjore” që të jenë kriter, të paktën favorizues për licensimet apo certifikime të ndryshme në fushën e psikologjisë.*
2. *Në një të ardhme sugjerojmë që pas një studimi të hollësishëm dhe referuar kërkesave të tregut të punës mundet që ky program studimi profesional të ristrukturohet në një Master të Shkencave në Psikologji Ligjore.*

3. *Të punohet për rritjen e numrit të studentëve të regjistruar në këtë program studimi, kjo edhe nëpërmjet mundësisë për të ndjekur këtë program studimi edhe studentë që kanë përfunduar studimet "Bachelor" dhe në fusha të tjera të shkencave shoqërore.*
4. *Të shtohen përpjekjet në drejtim të mobiliteteve të studentëve të këtij programi me institucione partnere jashtë vendit.*

Evaluation's conclusions for the second cycle study program Professional Master in "Legal Psychology" provided by the Higher Education Institution "University of Tirana".

Strengths and affirmations

1. Qualified academic staff ëith scientific titles and degrees, as ëell as experience and contributions to the development of the science of psychology.
2. Involvement of academic staff and students in important national and international projects.
3. Extensive collaboration in the context of professional practice, thus enhancing practical skills of students
4. Access in electronic contemporary sources
5. High quality of the curriculum comparable to European standards

Weaknesses

1. The number of students enrolled in this study program has been decreasing from one academic year to the next.
2. Student mobility towards international organizations abroad is very limited.

Recommendation

1. Encouraging interest in this study program, based not only on the contemporary curriculum of the program, but also by cooperating ëith the relevant Institutions to enable the Professional Master's degree in "Forensic Psychology" to be a criterion, at least favorable for licensing or various certifications in the field of psychology.
2. In the future, ëe suggest that after a detailed study and referring to the demands of the labor market, this Professional Study Program may be restructured into a Master of Science in Legal Psychology.
3. Work to increase the number of students enrolled in this study program, also through the opportunity for students who have completed their Bachelor's degree in other fields of social sciences to attend this study program.




4. Increase efforts towards international student mobility with partner organizations abroad.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

